



DRITA ISLAME

Botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë / Çmimi: 250 Lekë / www.dritaislame.al

Viti XXXIV / Nr. 06 / Qershor 2025



Misioni i Tij
ishte paqja

عَلَيْهِ سَلَامٌ
وَيْسَلَامٌ



“DRITA ISLAME”

**Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë**

www.dritaislame.al

DREJTOR

Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR

Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA

Erzen Carja

KONTAKT:

Tel/fax +355 68 87 71 655

E-mail: mehmet.disha@kmsb.al


Viti XXXIV i botimit

Nr. 06 (505)


Qershor, 2025

ISSN 2226-7115

*Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen, nuk
paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.*



www.dritaislame.al



editorial

- 04** Misioni i tij ﷺ ishte paqja
Mehmet Disha

në fokus

- 06** Rëndësia dhe roli i hixhretit në botëkuptimin Islam
Dorian Demetja

lajme / aktivitete

- 08** **01-Zhvillohet finalja e kampionatit të futbollit mes xhamive të ndryshme të Tiranës**
02-Zhvillohet olimpiada e lëndëve fetare ndërmjet medreseve të vendit
03-Zhvillohet seminari i haxhit 2025
04-Zhvillohet konkursi ndërkombëtar i kuranit, për memorizimin, leximin dhe texhvidin e librit të shenjtë në Prishtinë
05-Inaugurohet faza e dytë e projektit në mbështetje të fëmijëve jetimë në Shqipëri
06-Këshilli i përgjithshëm i KMSH-së zhvilloi mbledhjen e parë për vitin 2025

refleksione

- 14** Filozofia e Islamit për bashkëjetesën me ata që kanë fe dhe kulturë tjetër / Dr. Muhamed Amareh

çështje fetare

- 20** A lejohet surrogacia në Islam?
Këshilli për Çështjet Fetare – insi.al

familja

- 22** Disa çështje rreth pushimeve verore
Redaksia

horizonti i besimit

- 24** Kryqëzimi i qytetërimeve - probleme dhe perspektiva
Dr. Mustafa Cerić
- 28** Detyrat në lidhje me pasurinë
Ebu Hamid Imam Gazali
- 30** Dita e parë e të dërguarit të Zotit ﷺ në Medinë / Tauland Bica
- 32** Pendimi - shenjë e imanit
Resul ef. Rexhepi

bota shpirtërore


- 34** Namazi dhe Apoptoza
Nilyfer Demi

hapësirë femënore

- 36** Ah sikur ta dinin
Hasan Selami

këndi i poezisë

- 38** Me male e me gurë, o Zot...
Junus Emre



MISIONI I TIJ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ *ishle pagja*

Jetëgjatësia e sistemeve të ngritura nga mendimet njerëzore nuk është parë të jetë e vazhdueshme. Një njeri i krijuar prej një fare të vetme e cila zhvillohet e vjen në jetë, të cilës i duhen vite që të mund të forcohet e të ngrihet në këmbë e që më pas të mësojë e të zhvillojë aftësitë e njohjes e të perceptimit, nuk mund të pretendojë ndonjë gjë të madhe, absolute e fundamentale në lidhje me këtë univers. E megjithatë, duke përfutur nga njohuritë e Zotit të lëna për njerin dhe nga ligjet e vëna prej Tij, disa mendje, si bëhen të mprehta, zhvillojnë sisteme, shpeshherë duke pretenduar gjëra që nuk janë në fuqinë e takatit të tyre.

Kur vjen puna te profetët, çështja nuk është kështu. Profetët vijnë me mesazhin e qartë prej Krijuesit, i cili, duke qenë Filluesi i gjithçkaje e i Gjithëdituri, Krijuesi i gjërave nga hiçi dhe i Gjithëpushtetshmi, i Cili e njeh më së miri jetën dhe universin, njeriun dhe botën e tij, shoqëritë dhe të gjitha punët e nevojshme. Kështu, jetëgjatësia e fjalës së profetëve në thelb, është e paprekshme. Ndodh që mendjet njerëzore, intrigat dhe planet djallëzore, përpiqen të mbulojnë të vërtetën dhe të mveshin djallëzitë e tyre bashkë me dritën e qartë hyjnore, gjë që çon në trazimin e mendjeve epokë pas epoke, mirëpo, edhe kjo gjë, është një sprovë për mendjet dhe zemrat njerëzore.

Ardhja e Profetit Muhamed a.s. qe pikërisht në një kohë ku më së shumti njerëzimi kishte nevojë për dritë që të dallonte ku ndante errësira, hija me të vërtetën. Dhe ja, gati 14 shekuj më vonë, Kur'ani dhe Suneti profetik, dy bazat themeltare të fesë Islame, qëndrojnë të paprekura nga sistemet e lëvizshme, të paprekura nga koha.

Ashtu siç një pemë e cila gjallon me gjelbërimin e saj duke u mbushur me gjethe, lule e më pas më fryte, tregon qartë se rrënjët i ka thellë të ngjeshura në një vend të mirë ku ushqehet me mineralet e nevojshme e ujë, po ashtu edhe një sistem jetëgjatë tregon rrënjët e vitalitetit mbi të cilin është ngritur, dhe është për këtë arsye që, Profeti Muhamed a.s. më mësimet e porositë e tij, i ardhur me urdhër të Zotit, i mbështetur dhe i ndihmuar prej Tij, i udhëzuar e i mësuar po prej Tij, vetëm sa lundron nëpër shekuj dhe vitet e kohërat, zhvillimi i shkencës dhe i njohjes njerëzore vetëm sa e vërteton dhe ja shton gjallërimin në çdo horizont!

Të gjithë bashkohen se Ai është njeriu që la më shumë mbresë dhe ndikim në historinë njerëzore. Mbi të gjitha një njeri i madh, një profet i denjë, një prijës sypatrembur, një diplomat i zoti, një komunikues i shkëlqyer, një paqebërës i vendosur, një falës i devotshëm, një baba shembullor, një bashkëshort i dashur. Këto janë vetëm disa cilësi që parë me pasqyrën e shekullit të 21-të,

janë të gjitha cilësitë që i kërkohen një njeriu të suksesshëm sot... sa arrijmë t'i realizojmë ne të gjitha këto (kuptohet përveç profetësisë që ishte e drejtë që Zoti ia dha vetëm atij) kjo është çështja. Askush të mos thotë se vlerat që ai la pas janë mbuluar nga mjegulla e kohës dhe pluhuri i harresës. Ende sot njerëzit kanë nevojë për njerëz besnikë, apo "emin", siç e thërrisnin atë rrugëve të Mekës, Medinës, Jerusalemit e Damaskut... Njerëzit duan paqen e jo luftën. Dhe ai ishte paqebërësi më i madh... ai shkoi në luftë vetëm kur u sulmua. Ai nuk sulmoi, shau, denigroi, përfoli apo... dikë. Ai shtriu dorën për myslimanë, të krishterë, hebrenj, budistë, madje edhe për jobesimtarët. Ky ishte misioni i tij PAQJA, mision i cili na bie ne myslimanëve nga një copë si detyrë që Ai na e ka lënë. Njerëzit duan që të jetojnë me trimat... dhe ai ishte i tillë. Por nuk ishte hakmarrës e jo e jo i rrëmbyer si një lumë në vjeshtë. Ai ishte trim, sepse, mbi të gjitha, dinte të ruante rrëmbimin e inatit dhe hasmërisë. Ishte Ai që e mësoi Aliun se armiku luftohet për hir të Zotit dhe jo për hir të robit...dhe Aliu uli shpatën kur armiku përballë e pështyu... "të luftoj për Zotin, i tha e jo për veten time..." Njerëzit duan të kenë të bëjnë me diplomatë të shkëlqyer që me asnjë komb të mos kenë probleme. Dhe Ai ishte një kryediplomat ftesën e të cilit edhe mbreti i krishterë Nexhashiu e priti me besim. Është ai modeli që i duhet diplomacisë botërore për të sheshuar luftën që ka plasur në Shtëpinë e Ibrahimit... Njerëzit duan të kenë përballë një model e të jenë komunikues të shkëlqyer... dhe ai ishte i tillë. Zëri i tij, syri i tij, dora e tij dhe argumenti i tij, zbutën zemra burrash të ashpër që kishin shkuar për ta vararë... Ai është modeli i komunikimit që njerëzimi kërkon. Njerëzit kanë nevojë për falje, të mos ndëshkohen për ato që bëjnë me hir a me pahir... dhe ai ishte falës i madh. Ai besonte se kush fal në këtë botë, i Gjithëmëshirshmi do ta falë në botën tjetër. Ai është modeli i zemërbutësisë dhe i sakrificës, i cili, edhe vrasësin e komandantit të parë mysliman, Hamzait, rahmeti i Allahut qoftë mbi të, e fali... Njerëzit duan të kenë prindër të mirë e të dashur dhe bashkëshortë idealë... ai ishte i tillë dhe dëshmitarë janë të afërmit dhe pasuesit e tij. Ai është, o lexues durimtar i këtyre rreshtave, modeli që njerëzimi ka kërkuar e po kërkon; ai është modeli që vetë ne myslimanët ende nuk e kemi kuptuar; ai është modeli që të tjerët e kanë keqkuptuar; ai është modeli që ende ka popuj në botë që nuk e njohin... Ai është modeli që mund ta nxjerrë këtë botë nga bataku i luftës, xhelozisë, pabesisë dhe dredhive.

Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, familjen dhe gjithë pasuesit e tij që nga dita e parë e gjer në përfundim të kësaj jete.

Rëndësia dhe roli i hixhretit në botëkuptimin Islam



Fjala hixhret do të thotë emigrim, shpërngulje, braktisje dhe ndarje nga diçka. Hixhreti i ka rrënjët qysh nga profeti Adem (a.s.) me zbritjen e tij në tokë. Shumë të dërguar të Allahut (xh.sh.) kanë pasur hixhretin e tyre, si profetët Ibrahim, Musa, Jusuf, Isa etj. (Paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi ta). Ndërsa, viti Hixhri, fillon me emigrimin e Profetit Muhamed (a.s.) nga Meka në Medine.

Myslimanët mekas, duke iu përgjigjur ftesës së mysli-manëve medinas, si dhe me lejen e Profetit, në pjesën e parë të shekullit VII, nisën të emigronin

fshehtas në Medine për të gjetur shpëtim, prehje e qetësi, ku lirisht mund të shprehnin ndjenjat e tyre fetare. Myslimanët mekas që emigruan nga Meka për në Medine, u quajtën muhaxhirë (emigrantë), kurse mysli-manët medinas që i pritën këta si vëllezër dhe miq, i respektuan dhe i ndihmuan, u quajtën ensarë (ndihmëtarë).

Profeti Muhamed (a.s.) së bashku me shokun e tij të ngushtë Ebu Bekrin, emigruan të fundit. Medineja ishte ngritur në festë duke e pritur profetin me padurim, dashuri dhe hare. Kjo ngjarje e madhe me rëndësi në

historinë Islame njihet me emrin Hixhreti Profetik dhe ky vit hënor quhet Viti i Ri Hixhri. Nisur nga rëndësia dhe roli i tij, myslimanët e kanë përcaktuar hixhretin si fillimin e kalendarit të tyre. Të gjitha ngjarjet historike më pas në fenë Islame, u renditën në bazë të kësaj pikënisjeje.

Hixhreti i myslimanëve nga Meka në Medine shënohet si një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë Islame. Në Kuran Allahu thotë: **“Ata që besojnë, emigrojnë dhe luftojnë për çështjen e Allahut dhe ata që japin strehim atyre e i ndihmojnë, pa dyshim, janë besimtarë të vërtetë. Për ta ka falje dhe shpërblim bujar.” (Enfal, 8:74)**

Hixhreti i Profetit Muhamed (s.a.s.) dhe i myslimanëve nuk ishte ikje nga frika për jetën e tyre, por një sakrificë e madhe realizuar vetëm për hir të Allahut dhe në shërbim të besimit. Myslimanët mekas lanë pas pjesëtarë të familjes, shtëpi, kopshte, mall, pasuri e tregti. Kështu që emigrimi, hixhreti, paraqet kulmin e sprovës dhe sakrificës materiale.

Mes myslimanëve emigrues, ishte dhe një person që kishte për qëllim të martohej me Ummul Kajsin në Medine. Dhe ai u quajt në përputhje me qëllimin e tij si “muhaxhiri i Ummul Kajsit.” Kjo, përveç se pasqyron qartazi se hixhreti nuk është thjeshtë zhvendosje fizike nga një vend në një tjetër, shpjegon gjithashtu se ai pasohet nga arsyet e braktisjes së gjërave. Njeriut i takon vetëm ajo çfarë ai synon dhe ka për qëllim.

Hapat e para të Profetit (a.s.) ishin themelimi i xhamisë së parë në Kuba, i shkollës Sufasë brenda në xhaminë e Medines dhe bashkimi e vëllazërimi i medinasve me mekasit. E para tregon bazën religjioze dhe hyjnore, e dyta bazën e dijes dhe të shkencës, kurse e treta paraqet nivelin më të lartë të një shoqërie kur ajo është e bashkuar, apo të paktën, kur tashmë njerëzit jetojnë duke e ndjerë veten të lirë.

Me hixhretin bota hyri në kontakt me valën e re të Islamit, i përfaqësuar me madhështinë e tij të vërtetë, i çliruar nga të gjitha forcat e diskriminimit racor e klasor dhe me besimin në një të Vetmin Zot, Allahun (xh.sh.) me të Cilin askush nuk është i barabartë.

Gjurmët që la Hixhreti tek brezat e myslimanëve janë të pashlyeshme, sepse me hixhretin nis epoka e lavdishme e themelimit të bashkësisë Islame, e cila ishte e zhveshur nga paganizmi, idhujtaria, primitivizmi dhe injoranca.

Me hixhretin, kultura islame u bë e veçantë dhe e kompletuar, ndërsa ngjarjet e lidhura me këtë rast, do të jenë burim frymëzimi për myslimanët për harmoni reciproke dhe vëllazërim Islam. Pikërisht me hixhretin u ngrit dhe u zhvillua shteti Islam i bazuar në Kur'an dhe Sunet, i cili brenda një kohe të shkurtër e shpërndau drejtësinë Islame në tre kontinente, duke u bërë një fuqi kryesore diturie e kulture në botë.

Çështje e vërteta, në kuptimin e vet specifik, hixhreti ka mbaruar, sepse i dërguari i Allahut thotë: “Pas

triumfit të Mekës nuk ka më hixhret” (Buhari, Xhihad, 1; Muslim, Imare, 85). Por në kuptim të përgjithshëm, hixhreti vazhdon dhe do të vazhdojë gjer në kiamet. Çdo njeri që ka besuar, i cili lë vendin e vet, nënën, babanë, të dashurit e miqtë dhe shkon vend më vend me synimin për t'u treguar të drejtën dhe të vërtetën zemrave nevojtare, ndodhet në kuadrin e dobishëm të një hixhreti, emigracioni të pambarim dhe pa asnjë diskutim që do ta marrë sevapin dhe të mirën e kësaj pune.

Hixhreti nuk është vetëm material, por edhe shpirtëror. I dërguari i Allahut na sqaron që, emigranti më i madh është ai që largohet prej mëkateve dhe që i fshin prej zemre të gjitha dashuritë përveç dashurisë për Allahun (Buhari, Iman, 4; Ibn Maxhe, Fitën, 2). Për këtë qëllim, edhe ne duhet të bëjmë hixhret me veprat tona, nga ajo me gabime dhe gjynahe, drejt idealeve, drejt botës së pastër morale, duke lënë pas vitet që na shkuan si gjurmë mësimdhënëse.

Përkujtimi i hixhretit në fillimin e çdo viti, na bën më të ndërgjegjshëm dhe më të përgjegjshëm për rëndësinë e përpjekjes në rrugën e Allahut, në rrugën e thirrjes në Islam, në rrugën e paqes dhe tolerancës, dashurisë dhe respektit të thellë ndaj çdo njeriu. Besimtarët e ndershëm duhet ta jetojnë hixhretin duke ruajtur me kujdesin më të madh mesazhin e tij, duke bërë hixhret të vazhdueshëm nga e keqja në të mirë, nga e shtrembra tek e vërteta, nga ngushtësia në zemërgjerësi, nga tradhtia në besnikëri, nga dyftyrësia në sinqeritet dhe çiltërsi shpirtërore.



01 ZHVILLOHET FINALJA E KAMPIONATIT TË FUTBOLLIT MES XHAMIVE TË NDRYSHME TË TIRANËS



Pas një jave plot emocion, mbrëmjen e djeshme u zhvillua finalja e kampionatit të futbollit për të rinjtë e xhamive të ndryshme të Tiranës, kompeticion ky i organizuar nën kujdesin e z. Erjol Haxhiu, Drejtor i Drejtorisë së Thirrjes dhe Mesazhit Islam dhe z. Shpëtim Seranaj, Drejtor i Drejtorisë së Marrëdhënieve me Besimtarët në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë.

Nëntë ekipet pjesëmarrëse i zhvilluan takimet e tyre në fushë të madhe me formacion 9 me 9, ndërsa atmosfera sportive dhe vëllazërore shoqëroi çdo përballje mes të rinjve.

Fitues i kampionatit u shpall ekipi i Xhamisë së Botanikut, ndërkohë që u ndanë edhe çmime individuale si Këpuca e Artë dhe Topi i Artë për lojtarët më të spikatur të kampionatit.

Në këtë kompeticion morën pjesë ekipet përfaqësuese të dy xhamive të Kombinatit, xhamisë Pezë, Menik, Botanik, Mahmud Vrapit dhe zonave të tjera përreth.

Allahu (xh.sh) i shpërbleftë imamët e xhamive pjesëmarrëse, të cilët përveç angazhimit dhe punës së palodhur me të rinjtë, gjatë turneut, mbajtën referime dhe ndanë këshilla të vryera për të rinjtë mbi vlerat e Islamit, forcimin e vëllazërisë, angazhimin në aktivitete të dobishme dhe largimin nga veset. Ky kampionat u shndërrua në një hapësirë ku të rinjtë, imamët dhe xhemati u bashkuan përmes sportit dhe besimit, duke ndërtuar lidhje më të forta me njëri-tjetrin.



02 ZHVILLOHET OLIMPIADA E LËNDËVE FETARE NDËRMJET MEDRESEVE TË VENDIT



Drejtoria e Arsimit pranë Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, organizoi edhe këtë vit olimpiadën e lëndëve fetare, një aktivitet tashmë i kthyer në traditë disa vjeçare që nxit thellimin e njohurive, promovimin e ekselencës dhe garën mes nxënësve të medreseve të vendit.

Ky aktivitet, zhvillohet në dy faza, në fazën e parë morën pjesë rreth 50 nxënës nga të gjitha medresetë e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, fazë e cila u zhvillua ditën e shtunë në ambientet e Medresesë Tiranë dhe përfshiu provimin me shkrim në lëndët Gjuhë Arabe, Fikh, Besim dhe Kuran.

Në nisje të saj, Drejtori i Arsimit në KMSH, z. Elton Karaj, pasi falenderoi nxënësit dhe mësuesit e pranishëm për pjesëmarrjen, theksoi rëndësinë e këtij organizimi si një model suksesi në edukimin e brezave të rinj dhe ruajtjen e vlerave të trashëgimisë islame.

Më tej, ai ndau me ta rregullat dhe udhëzimet përkatëse për një proces sa më transparent dhe të drejtë.

Faza e dytë do të zhvillohet më 17 Maj në ambientet e Kolegjit Universitar "Bedër", ku do të përfshihen 4 kategori në leximin e Kuranit Famëlartë. Në këtë fazë do të shpallen edhe fituesit për çdo disiplinë të olimpiadës dhe do të shpërndahen certifikatat përkatëse për më të mirët.

Përzgjedhja e pjesëmarrësve në të dyja fazat është bërë mbi bazën e kriterëve të përcaktuara nga Komisioni Organizues.

Kjo olimpiadë mbetet një ndër aktivitetet më të rëndësishme vjetore të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë në fushën e arsimit fetar, duke përfaqësuar një model suksesi në edukimin e brezave të rinj.



03 ZHVILLOHET SEMINARI I HAXHIT 2025



Zyra e Haxhit dhe Umres pranë Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, zhvilloi më 10 Maj, në ambientet e Medresesë "Tiranë", një seminar informues mbi itinerarin, kushtet dhe rregullat e haxhit me besimtarët që pritet të nisen drejt vendeve të shenjta në fund të këtij muaji.

Koordinatori i haxhit në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, z. Lauren Luli, së bashku me stafin e tij administrativ dhe atë mjekësor, ndanë me të pranishmit udhëzimet dhe porositë e fundit para nisjes.

Gjatë referimit ata ndanë me besimtarët specifikat e veshjes së ihramit, specifikat e qëndrimit në Mina, Arafat, Muzdelife, hedhjen e gurëve në xhemarat, kryerjen e tavafit, sajin ndërmjet kodrave Safa-Merve, shkurtimin e flokëve, udhëzime të ndryshme mjekësore, etj.

Ky seminar u transmetua njëherazi edhe nëpërmjet platformës online "Zoom" për të gjithë besimtarët që nuk mundën të merrnin pjesë fizikisht.

I njëjti seminar do të zhvillohet gjithashtu më 17 Maj, në po të njëjtën orë dhe ambient, për tu dhënë mundësinë pjesës tjetër të mbetur të besimtarëve të marrin udhëzimet e nevojshme.



04 ZHVILLOHET KONKURSI NDËRKOMBËTAR I KURANIT, PËR MEMORIZIMIN, LEXIMIN DHE TEXHVIDIN E LIBRIT TË SHENJTË NË PRISHTINË



Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mori pjesë në ceremoninë përmbylëse të Konkursit Ndërkombëtar të Kuranit, për memorizimin, leximin dhe texhvidin e librit të shenjtë.

Këtë vit, ky kompeticion u zhvillua në Kosovë, nën kujdesin e veçantë të Ministrisë së Çështjeve Fetare të Mbretërisë së Arabisë Saudite, përmes Atasheut së saj Fetar në Sarajevë, në bashkëpunim me Ambasadën e Mbretërisë së Shqipëri dhe me Bashkësinë Islame të Kosovës.

I ftuari i nderit i këtij edicioni ishte imami i Xhamisë së Shenjtë të Qabesë, H. Bender Balla.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ishte ndër kontribuesit kryesorë të këtij eventi të rëndësishëm, me pjesëmarrjen e 31 garuesve – një dëshmi e përkushtimit tonë të vazhdueshëm në shërbimin të Librit të Allahut Fuqiplotë dhe edukimit të brezave të rinj me vlerat e tij hyjnore.

Përkushtimi i palodhur dhe përgatitja dinjitoze e të rinjve nga Shqipëria solli rezultate të shkëlqyera për ta, duke fituar çmime të para, të dyta dhe të treta sipas kategorive përkatëse.

Në këtë kuadër, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë shpreh mirënjohje ndaj udhëheqjes së Mbretërisë së Arabisë Saudite – Madhërisë së Tij Mbretit Selman bin Abdulaziz Al Saud, Lartmadhërisë së Tij Princit të Kurorës Mohammed bin Salman, si dhe Ministrit të Çështjeve Fetare, H. Dr. Abdul Latif bin Abdulaziz Al Sheikh – për mbështetjen e vazhdueshme dhe përpjekjet e palodhura në shërbim të Kuranit Famëlartë dhe përhapjen e vlerave islame në mbarë botën.

Gjatë këtij aktiviteti, kryetari Spahiu u shoqërua nga nënkryetari i institucionit z. Lauren Luli dhe myftiu i Krujës, z. Ermir Gjana.



05 INAUGUROHET FAZA E DYTË E PROJEKTIT NË MBËSHTETJE TË FËMIJËVE JETIMË NË SHQIPËRI



Zhvilohet ceremonia e nisjes së fazës së dytë të projektit "Në ndihmë të fëmijëve jetimë të Republikës së Shqipërisë" në ambientet e Medresesë Tiranë. Projekti, tashmë për të dytin vit radhazi, financohet nga Qendra Bamirëse "Mbreti Selman" dhe zbatohet nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë në bashkëpunim me Ambasadën e Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë.

Në ceremoninë e hapjes, morën pjesë: Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Ambasadori i Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë, z. Fajsal Gazi Hifdhi, Nënkrjetari i KMSH-së, z. Lauren Luli, myftinjtë nga rrethet e ndryshme të vendit ku shtrihet projekti, si dhe familjarë dhe fëmijë përfitues.

Në fjalën e tij përshëndetëse, kryetari Spahiu shprehu vlerësimin për vazhdimësinë e këtij bashkëpunimi me qendrën "Mbreti Selman". Ai theksoi se për KMSH-në është nder të jetë partner kryesor në mbështetjen e 150 fëmijëve jetimë në 10 rrethet e ndryshme të vendit.

Ndërsa Ambasadori Hifdhi përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se mbështetjet e kësaj natyre janë shprehje e vizionit humanitar të mbretit Selman.

Po ashtu, në emër të familjarëve dhe fëmijëve përfitues të këtij projekti, ndanë përshtypjet e tyre një nënë dhe një fëmijë i pranishëm në aktivitetin inaugurues. Ata u shprehën se ndihma financiare mujore ka qenë një lehtësim i madh për familjen, sidomos për përballimin e nevojave bazë të fëmijëve si ushqimi, veshmbathja apo shkolla. Në përfundim të ceremonisë, u shpërndanë në mënyrë simbolike mbështetjet financiare mujore për muajin Maj.



06 KËSHILLI I PËRGJITHSHËM I KMSH-SË ZHVILLOI MBLEDHJEN E PARË PËR VITIN 2025



Mbledhja u çel me leximin e disa ajeteve kuranore nga Drejtori i Arsimit në KMSH dhe njëherazi imami i xhamisë “Et’hem Bej” në Tiranë, z. Elton Karaj, për të vijuar me fjalën hapëse të Kryetarit të Këshillit të Përgjithshëm të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Islam Hoxha.

Më tej, fjalën e mori Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili shprehu mirënjohjen e tij për të gjithë anëtarët e pranishëm, duke vlerësuar kontributin e tyre të çmuar në mbarrëvajtjen e veprimtarisë institucionale. Ai prezantoi një përmbledhje gjithëpërfshirëse të aktiviteteve më të rëndësishme të Komunitetit Mysliman që nga mbledhja e fundit, duke evidentuar arritjet më të spikatura, projektet e realizuara, si dhe sfidat me të cilat është përballur institucioni në përmbushjen e misionit të tij fetar, arsimor dhe shoqëror. Mbledhja vijoi me prezantimin e raportit të Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm, nga z. Islam Hoxha, i cili këtë herë u ndal në ecurinë e aktiviteteve fetare dhe administrative të Myftinisë Pogradec, duke ofruar një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar mbi punën e kryer gjatë periudhës në shqyrtim.

Në vijim të mbledhjes, Kancelari i institucionit, z. Fejzi Shaholli, prezantoi një raport të hollësishëm mbi veprimtaritë e Kryetarit Spahiu, aktivitetin e drejtorive dhe vendimet e Kryesisë të ndërmarra që nga mbledhja e fundit. Një nga pikat kryesore të kësaj mbledhjeje ishte prezantimi i platformës më të re online nga Drejtori i Drejtorisë së Vakf-Investimeve, z. Erlis Moshë. Në fjalën e tij, z. Moshë bëri një paraqitje të detajuar të kësaj platforme inovative, e cila mundëson akses të hapur për publikun, duke i lejuar qytetarët dhe donatorët të informohen në kohë reale mbi ecurinë e projekteve në zhvillim, si dhe të kontribuojnë financiarisht në mënyrë të drejtpërdrejtë për realizimin e tyre.



FILOZOFIA E ISLAMIT PËR BASHKËJETESËN ME ATA QË KANË FE DHE KULTURË TJETËR

Kur'ani Fisnik ka ngritur një filozofi të dalluar islame në vizionin e tij për gjithësinë, jetën dhe marrëdhëniet mes gjallesave. Në këtë filozofi të dalluar islame ndodhen shenjat kryesore, disa prej të cilave ne mund t'i tregojmë sa vijon:

A- Uniteti dhe Njësimi janë vetëm për Esencën Hyjnore.

B- Larmia, dallimi, shumësia dhe kundërshtia janë praktika hyjnore kozmike të qëndrueshme në botët e krijesave të tjera. Kjo shumësi është në kuadrin Unitetit të Origjinës, të cilën e ka krijuar Allahu xh.sh. Kështu, njeriu, të cilin e krijoi Allahu prej një njeriu të vetëm, u bë i larmishëm në popuj, fise, kombe e në ngjyra. Gjithashtu ai u bë i ndryshëm edhe në legjislacione në kuadrin e një feje të vetme. Ai u bë i larmishëm në metodologji, domethënë në kultura e civilizime në kuadrin e vetëm të pjesëmarrjes njerëzore.

Gjithashtu ai u bë i larmishëm në zakone, tradita e shprehi të dalluara, madje edhe brenda kulturës së vetme. Kjo larmi, kjo kundërshtia dhe ky dallim e tejkalojnë qenien e tyre si një "e drejtë" prej të drejtave të njeriut dhe kalojnë te qenia e tyre një "praktikë" prej Praktikave të Allahut. **"O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu të vetëm, e nga ai krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej atyre të dyve krijoi burra dhe gra të shumtë..."** (En-Nisa, 4:1). **"Se po të kishte dashur ashtu Zoti yt, Ai padyshim që do ta kishte bërë njerëzimin një umet (popull) të vetëm, por ata nuk do të pushojnë në mospajtimin e tyre. Përveç atij mbi të cilin Zoti ka dhuruar mëshirën e Tij. Dhe mu për këtë Ai i krijoi ata".** (Hud, 11:118-119). Ashtu siç thonë komentuesit, "Për mospajtim i krijoi ata". Kështu, Uniteti dhe Njësimi janë vetëm



për Allahun, të Vërtetin, ndërsa shumësia është praktika dhe ligji në të gjitha botët e krijesave.

C- Kjo larmi, ky dallim, kjo shumësi dhe kjo kundërshti kanë synime të shumta. Prej atyre synimeve janë: Përbushja e motiveve të garës në rrugën e mirësive midis grupeve të dalluara, **"Për secilin prej jush Ne kemi përshkruar një ligj dhe një rrugë të qartë. Po të kishte dashur Allahu, Ai do të kishte mundur t'ju bënte ju një komb, por (qëllimi i Tij është) që t'ju provojë ju në atë që Ai ju ka dhënë, kështu që përpiquni e bëni garë për vepra të mira"**. (El-Maideh, 5:48). Gjithashtu prej këtyre synimeve është 'hapja e dyerve të lirisë për ixhtihad' (për të interpretuar ligjin e shenjtë), për ripërtëritje e risi, të cilat nuk mund të realizohen pa veçim, pa dallueshmëri e pa kundërshti. **"Për gjithsecilin është një synim**

drejt të cilit Allahu e kthen atë..". (El-Bekare, 2:148).

Ç- Lidhja e grupeve të dalluara, mospajtuese dhe të shumëllojshme, duhet të mbetet brenda kuadrit të institucioneve të unifikuara dhe te niveli i ekuilibrit, i drejtësisë dhe i së mesmes së artë. **"Kështu, pra, Ne ju kemi bërë një Umet të së Mesmes së Artë"**. (El-Bekare, 2:143). "El-Uasat" (e Mesmja e Artë) sipas versionit të Hadithit Profetik ka kuptimin e "Drejtësisë", e cila duhet të sundojë marrëdhëniet e grupimeve mospajtuese". (Transmeton Imam Ahmedî).

D- Në qoftë se prishen ekuilibrat e drejtësisë dhe të së mesmes së artë, mes grupimeve mospajtuese dhe të dalluara në klasat shoqërore, ose në legjislacionet fetare, ose në filozofitë apo civilizimet, filozofia islame

aprovon rrugën e “luftës mbrojtëse”, e cila është lëvizja që drejton qëndrimet, pozicionet dhe orientimet, duke i kaluar këto, nëpërmjet saj, prej nivelit të defektit, të padrejtësisë, tiranisë dhe të armiqësisë, për te niveli i drejtësisë, i ekuilibrit, i së mesmes së artë, i bashkëjetesës dhe i njohjes së ndërsjellë, dhe njëkohësisht, duke ruajtur vazhdimësinë e larmisë, dallueshmërisë, shumësisë dhe të kundërshtisë: **“Nuk mund të jenë kurrë njësoj e mira dhe e keqja. Largoje (të keqen) me atë që është më e mirë. Pastaj ja! Ai, mes të cilit dhe mes teje pati armiqësi (do të bëhet) si të ishte mik i ngushtë”**. (Fussilet, 4:34).

Kjo “luftë mbrojtëse” është e mesmja e Artë midis ‘tefrit’ (mangësisë) së “mosreagimit” dhe midis ‘ifrat’ (teprisë) së “konfliktit”, dhe është zhvilluesi i larmisë, i rivalitetit dhe i garës në rrugën e veprave të mira. Ndërsa mosreagimi çon në vdekjen e të pafuqishmëve, ashtu si konflikti që çon tek i njëjti rezultat, sepse i forti hedh përtokë të dobët, duke mbetur i vetëm në shesh. Gjithashtu kjo do t’i jepte fund pluralizmit, dallueshmërisë dhe kundërshtisë. Kështu, lufta mbrojtëse është ajo që drejton qëndrimet e padrejta, duke ruajtur vazhdimësinë e pluralizmit, rivalitetit dhe të garës në rrugën e bërjes së veprave të mira. Atëherë kjo është rruga për reformim në mbrojtjen e larmisë dhe të shumësisë dhe jo për t’i rrënuar larminë dhe shumësinë: **“Dhe nëse Allahu nuk do t’i provonte një grup njerëzish me anë të një grupi tjetër, toka sigurisht që do të ishte mbushur plot djallëzi e pabesi. Por Allahu është Dhuruesi i madh i shumë mirësive për botët (për njerëzit dhe xhindet dhe për gjithçka)”**. (El-Bekare, 2:251).

Ky është qëndrimi i larmisë, i shumësisë dhe i dallueshmërisë në vizionin islam lidhur me gjithësinë, me jetën dhe me marrëdhëniet midis botëve të krijesave e ideve dhe lidhur me rolin e kësaj larmie në progres e reformim. Ky është dallimi i filozofisë islame nëpërmjet së Mesmes së Artë Gjithëpërfshirëse Islame nga të tjerat prej tendencave dhe filozofive detyruese e bashkëshkrirëse të të gjithave në një, ose prej tendencave dhe filozofive të konfliktit, të cilat i çojnë të tjerat në veçimin te një taraf i vetëm, i cili është më i forti në shesh e në privilegje. Të dyja anët e ekstremist çojnë tek i njëjti përfundim. Midis atyre të dyjave në këtë mejdan dallohet e Mesmja e Artë Islame.

Bashkëjetesa me ata që kanë besim tjetër

Në Shtetin e Profetësisë, në Medinën e Ndriçuar, i Dërguari i Allahut shpalli tre ligje,

të cilët mishëruan filozofinë e Islamit në marrëdhëniet me të tjerët, që kanë besim tjetër fetar, me pasuesit e Shkrimeve të Shenjta dhe me ata të të drejtave formale: me hebrenjtë, të krishterët, me mexhusët dhe me ata që u përngajnë atyre. Këto ligje profetike sigurisht u projektuan për të shprehur këtë filozofi islame, në dokumente kushtetuese, të cilat i vuri në zbatim Shteti i Profetësisë. Atyre ligjeve iu përmbajt shteti i kalifatit të drejtë dhe gjithashtu parimet e tyre u ruajtën deri në një farë mase përgjatë historisë së civilizimit islam dhe në vendet islame.

1-Bashkëjetesa me hebrenjtë

I pari i këtyre dokumenteve kushtetuese është “Konventa”, kushtetuta e Shtetit të Medinës së Ndriçuar. Atë konventë e hartoi i Dërguari i Allahut menjëherë pas Hixhretit dhe sapo ngriti “Shtetin”, me qëllim që të përcaktonte kufijtë e shtetit dhe elementët përbërës të nënshtetasve të tij, të drejtat dhe detyrimet e unioneve të nënshtetasve me ata midis tyre që kanë fe tjetër (hebrenjtë arabë dhe aleatët e tyre hebrenj) dhe që të përcaktonte gjithashtu ligjin referues dhe kompetencat për drejtimin e shtetit dhe të nënshtetasve të tij. Në këtë dokument kushtetues folën dispozitat ligjore të tij - që ishin më shumë se 50 paragrafë - për larminë fetare në kuadrin e një Umeti të porsalindur dhe të një shteti të ri, dhe rreth barazisë midis grupimeve të ndryshme. Ato dispozita ligjore folën rreth marrëdhënieve mes myslimanëve dhe hebrenjve, domethënë rreth larmisë fetare në kuadrin e unitetit të popullit. *“Hebrenjtë janë një popull bashkë me besimtarët. Hebrenjtë kanë fenë e tyre dhe myslimanët kanë fenë e tyre. Ata kanë avokatët dhe individët e tyre. Hebrenjtë janë të mbrojtur ashtu si myslimanët, me përjashtim të atij që bën padrejtësi e mëkat; një njeri i tillë nuk shkatërron veçse veten e tij dhe njerëzit e shtëpisë së tij. Ata që na binden neve prej hebrenjve, sigurisht do të kenë mbështetjen, vlerësimin dhe nderimin e pastër prej kësaj konvente; atyre nuk do t’u bëhet padrejtësi dhe ata nuk do të mbeten pa mbështetje. Ata japin bashkë me myslimanët për sa kohë që janë luftëtarë. Hebrenjtë kanë shpenzimet e tyre dhe myslimanët kanë shpenzimet e tyre. Ata do të kenë mbështetje kundra atyre që i luftojnë njerëzit e kësaj konvente. Midis tyre do të jetë këshillimi, konsulta dhe respekti, duke përjashtuar ata që mëkatojnë...”*

Ky dokument kushtetues ishte “akti i parë ligjor, shoqëror, politik dhe fetar”. Ai ishte një akt

ligjor i mirëfilltë dhe jo hipotetik dhe as imagjinar. Ai akt nuk mjaftohet vetëm me njohjen e tjetrit, por e bën tjetrin pjesë të nënshtetasve, të popullit dhe të shtetit, - domethënë e bën pjesë të vetvetes, - i cili i gëzon të gjitha të drejtat dhe merr përsipër të gjitha detyrimet. Ky akt ndodhi në një kohë në të cilën asnjë taraf nuk e njihte tjetrin në mënyrë të përgjithshme dhe absolute.

2- Bashkëjetesa me të krishterët

Sa për dokumentin e dytë kushtetues, ai ka të bëjë me marrëdhëniet me të krishterët. I Dërguari i Allahut e hartoi atë për të krishterët e Nexhranit, që të ishte një konventë për ta dhe për të gjithë ata që përqafojnë fenë e krishterë gjatë kohës. Kjo ngjarje ndodhi me marrëveshja e parë mes Shtetit Islam dhe besimtarëve të krishterë. Në këtë konventë kushtetuese i Dërguari i Allahut shkroi: *"Për Nexhranin dhe rrethinat e saj dhe për të gjithë të tjerët që kanë përqaftuar fenë e krishterë në vendet e tokës: Të gjithë ata janë nën mbrojtjen e Zotit dhe në garancinë e Muhamedit, të Dërguarit të Zotit. Gjithashtu janë të mbrojtura pasuritë, individët e populli i tyre, ai që nuk është i pranishëm, i pranishmi, tregtia dhe gjithçka që ndodhet në duart e tyre, qoftë e pakët apo e shumtë... Unë do të mbroja anën e tyre dhe do t'i mbroja ata dhe kishat e tyre. Do t'i mbroja tregtinë, shtëpitë e lutjeve, manastiret dhe shëtitoret e tyre. Unë do t'i mbroja fenë dhe popullin e tyre kudo që ata të jenë, ashtu siç mbroja veten time, pronat e mia dhe njerëzit e Islamit mes komunitetit tim, sepse unë u kam dhënë atyre besën e Zotit që ata të kenë e të gëzojnë atë çfarë gëzojnë myslimanët, dhe do të jetë kundra tyre ajo çfarë është kundra myslimanëve. Edhe myslimanët do të kenë atë çfarë kanë të krishterët derisa këta të jenë pjesëmarrës me myslimanët në atë çfarë është pro ose kundra tyre."*

Ky dokument arriti deri te njohja dhe pranimi i personit me fe tjetër, te respekti ndaj tij, te bërja e mundur për të që t'i mbrojnë gjërat e tij personale dhe deri te bashkëshkrimi i tij me të, gjë të cilën nuk e ka arritur asnjë dokument tjetër gjatë historisë njerëzore, me veçorinë më të madhe dalluese, që është "(ku mbyllet thonjëza?????)Bërja e kësaj larmie dhe kundërshtie në kuadrin e unifikimit të Umetit, duke mishëruar filozofinë e fesë islame në marrëdhënien me personin me fe tjetër, dhe jo duke rrënuar fenë dhe çdo fe tjetër.

Bashkëjetesa me njerëzit me besime të tjera ndryshe nga pasuesit e shkrimeve të shenjtë

Sa për ligjin e tretë profetik, ai përcaktoi

marrëdhëniet me anëtarët e besimeve të tjera, duke e zgjeruar rrethin për njerëzit e feve të ndryshme dhe duke i trajtuar ata ashtu siç trajtohen ehlul Kitab - Pasuesit e shkrimeve të Shenjta. Sigurisht, shteti i drejtë i kalifatit nisi ta zbatonte këtë ligj kur mexhusët u përfshinë në kuadrin e një nënshtetësie të vetme të shtetit të drejtë të kalifatit në kohën e kalifit të dytë Umer bin Hattab, Allahu qoftë i kënaqur me të. Hazreti Umeri e paraqiti këtë realitet të ri në seancën e këshillit konsultativ (në seancën e shtatëdhjetë të kuvendit) dhe pyeti: "Si të veprojmë unë me mexhusët?". Ndërkohë, u ngrit në këmbë Abdurrahman Bin Auf dhe tha: "Unë dëshmoj se i Dërguari i Allahut ka thënë: *'Zbatoni për ta ligjin që është në fuqi për Ehlul Kitab- Pasuesit e Shkrimeve të Shenjta.'*"

Tensionet fetare janë të përjashtuara prej ligjit profetik

Qysh prej shekullit të parë pas Hixhretit, Shteti Islam i garantoj të gjitha vendet, rajonet e krahinat, ashtu siç garantoj popujt, fiset, fetë, filozofitë dhe medhhebet. Ai shtet mishëroi të gjitha ngjyrat dhe spektrat e larmisë dhe të kundërshtisë, që njeriu njohu në atë histori (periudhë historike/ ose / në histori). Pas sundimit të kalifatit islam vijuan shtetet që u degëzuan prej tij dhe mbreti i tyre trashëgoi ngjyra prej kalifëve, mbretërve dhe princërve. Prej tyre kishte të mirë dhe të ligj. Mes tyre kishte të drejtë dhe të padrejtë. Gjithashtu, mes tyre kishte nga ata që bashkonin prej gjërave të kundërta. Asnjë njeri me mend nuk do të mund ta përfytyronte që një histori me këtë gjatësi (afërsisht pesëmbëdhjetë shekuj) për Umetin e kësaj larmie, për botën e kësaj shtrirjeje dhe nën hijen e sfidave të egra, të ishte pa tensione fetare mes grupimeve që jetuan në tokën e Islamit. Por shikimi i këtyre tensioneve fetare, të cilat janë shmangie prej ligjit profetik, që u miratua qysh prej shtetit të parë Islam në Medinën e Ndriçuar, duhet të jetë në madhësinë e tyre reale dhe në kuadrin e krahasimit të tyre me tensionet e civilizimeve të tjera, ashtu siç ndodhi midis protestantëve dhe katolikëve në luftërat fetare evropiane, që zgjatën më shumë se dy shekuj, duke asgjësuar dyzet për qind të popujve në mes të Evropës, dhe ashtu si luftërat mes të bardhëve dhe njerëzve me ngjyrë në Amerikë. Për më tepër, këto tensione fetare sektare duhet të shihen në kuadrin e shkaqeve reale që sollën pasojat dhe ngjarjet e tyre.

Ndoshta dëshmia e dijetarëve dhe e studiuesve jomyslimanë është dëshmuesi më

i mirë për realitetin e madhësisë së këtyre tensioneve dhe të shkaqeve të tyre.

Dijetari i shquar anglez, "Sir Tomas Arnold", dëshmon për lirinë fetare të cilën, Islami dhe civilizimi i tij, solli. Ajo liri përfshiu larminë dhe kundërshtinë. Ajo u dha mundësinë të krishterëve të lindjes të shpëtonin prej shfarosjes së romakëve bizantinë, saqë mund të thuhet se "vazhdimësia e krishterimit lindor është dhuratë e Islamit".

Dijetari i shquar gjerman, "Ademedz", flet rreth rolit të jomyslimanëve në administratën e departamenteve të Shtetit Islam gjatë historisë islame dhe thotë: "Sigurisht ishin të krishterët ata që sundonin vendet islame".

Studiuesi dhe historiani i krishterë libanez, "Xhorxh Kirem", ua referon tensionet fetare dhe sektare-kalimtare dhe të kufizuara, - të cilat i dëshmoi historia islame, - tre faktorëve:

1-Temperamenteve të çrregullta të disa sundimtarëve të cilët sunduan disa vende islame për disa kohë dhe të cilët i shtypën minoritetet si pjesë e shtypjes së tyre të përgjithshme ndaj të gjithë nënshtetasve.

2-Arrogancës së ministrave, drejtuesve dhe komandantëve jomyslimanë; epërsisë së tyre mbi masat e myslimanëve; pasurisë së tyre provokuese si dhe padrejtësisë dhe shtypjes së tyre ndaj të varfërve myslimanë, gjë e cila shkaktoi reagime sektare të cilat nuk ndaluan tek ata që bënë padrejtësi prej bijve të këtyre minoriteteve në veçanti, por fatkeqësia i përgjithësoi edhe masat e minoriteteve.

3-Tundimit të kolonizatorëve të huaj - kryqëzatave të Anglisë dhe të Francës - duke joshur sektorët në të cilët ishin bijtë e minoriteteve për të bashkëpunuar me pushtuesit dhe për të tradhtuar popullin dhe atdheun e tyre. Këto tundime kolonizatore patën sukses në shumë raste, gjë e cila shkaktoi reagime të ashpra kundra bijve të këtyre minoriteteve, të cilët ranë në rrjetën e tundimeve.

Marrëdhënia me ata që kanë kulturë tjetër

Në qëndrimin ndaj kulturave që u përhapën në sferën botërore dhe në kuadrin e civilizimeve joislame ndodhen tre qëndrime ku secili prej tyre ka përkrahës e mbështetës.

I pari i këtyre qëndrimeve është qëndrimi i të kulturuarit të "papunë". Është ai i cili e shfaq mendjen e tij si një fletë e bardhë pa asnjë qëndrim dhe pa asnjë veçori personale e civilizuese. Në të stampohen të gjitha ngjyrat e ardhura dhe të importuara, si të ishte mendja e tij njëra prej zyrrave të importit, me të cilën ai jeton dhe tek e cila ndodhet një përfaqësues tregtar "parazit" që nuk ka asnjë lidhje me prodhimin vendas e kombëtar dhe nuk ka asnjë lidhje me mendjet e tyre nëpërmjet novacionit ideologjik, kulturor e civilizues.

I dyti i këtyre qëndrimeve është qëndrimi i mbylljes ndaj të gjitha kulturave botërore dhe privimi për të përfutur prej eksperiencave të popujve të tjerë

në ruajtjen e gjuhëve të tyre, letërsive, arteve dhe kulturave të tyre si dhe privimi prej të gjitha ngjyrave të hapjes ndaj këtyre kulturave. Njerëzit e këtij qëndrimi ëndërrojnë me "të pamundurën", "të dëmshmen", dhe nuk e dëshirojnë realizimin e të pamundurës, sepse ndërtimi i mureve kineze midis kulturave botërore nuk u realizua në lashtësi, atëherë si do të mund ta ndërtanim ne në epokën e revolucionit dhe të mjeteve të kontaktit? Dhe kjo e pamundur është e dëmshme - duke supozuar se mund të realizohet -, sepse mbyllja kulturore i çon njerëzit në një gjendje dobësimi, ashtu siç i shkakton greva e urisë trupit të njeriut. Trupi ushqehet te vetvetja, e konsumon vetveten dhe, si rrjedhojë, ai goditet me tharje, atrofi dhe me zhdukje. Ashtu si përkatësia kulturore që i çon njerëzit e saj tek imitimi, i cili e shkrin dallimin dhe me të cilin zhduket individualiteti e veçantia, po ashtu edhe mbyllja çon në të njëjtin rezultat të dëshpëruar e tragjik.

Atëherë, edhe mangësia "tefrit", edhe tepria "ifrat" të dyja të çojnë në tragjedinë e venitjes dhe të zhdukjes individuale, patriotike dhe kombëtare në kulturë e civilizim.

Qëndrimi i ndërveprimit të ekuilibruar

Qëndrimi i tretë ndaj kulturave botërore është e Mesmja e Artë e Drejtë, e cila zgjedh rrugën e "ndërveprimit" me civilizimet dhe me kulturat botërore prej pozicionit të drejtë të pavarur pa tepri "ifrat", i cili çon në "mbyllje", dhe pa mangësi "tefrit", që çon në "përkatësi" dhe në imitim e shkrirje. Ky ndërveprim me kulturat botërore është ai që bën dallim mes karakteristikës sonë kulturore, e shfaqur në sistemin e vlerave islame, të cilat janë kriteret e pranimit dhe të refuzimit të asaj që është tek të tjerët, dhe mes asaj që është e përbashkët njerëzore e përgjithshme, qofshin këto të përbashkëta shkencat e sakta natyrore, asnjënjëse, ose vënia në zbatim e këtyre shkencave në teknikat nëpërmjet të cilave plotësohet realiteti material në shoqëritë islame, ose qoftë kjo pjesëmarrje njerëzore në fushat e përparimit kulturor e gjuhësor dhe të transplantimit të kulturës sonë dhe të pasurimit të saj me format e reja të dobishme në hapësirat e kulturës tjetër.

Ky qëndrim i tretë - qëndrimi i ndërveprimit kreativ mes kulturave dhe civilizimeve - është më i dobishmi; është e Mesmja e Artë e Drejtë mes ekstremimit të teprisë dhe mangësisë në mbyllje e veçim dhe në përkatësi e imitim. Madje ky qëndrimi i tretë (i së mesmes së artë, të ekuilibruar e të drejtë) gati është ligji i drejtë, i cili sundon marrëdhëniet e shëndosha dhe të matura mes kulturave dhe civilizimeve përgjatë historisë. Kur myslimanët u hapën ndaj kulturës së shkollës së Aleksandrisë në shekullin e parë të Hixhretit, ata i përkthyen shkencat e industrisë (teknikat e shkencave të sakta e asnjënjëse), por nuk përkthyen fetë e Egjiptit (idhujtarinë dhe krishterimin) dhe as filozofitë helene e të tjerat. Gjithashtu myslimanët nisën prodhimin

atëherë kur u hapën ndaj trashëgimisë Romane qysh prej epokës së kalifit të tyre Umer bin Hattabit. Ata morën vetëm sistemin e zyrove dhe nuk e morën ligjin romak. E njëjta ishte situata në ndërveprimin islam me civilizimin pers. Myslimanët morën përvojat perse në sistemet dhe organizimet administrative, por nuk morën filozofinë e mexhusëve dhe as besimet e tyre fetare. Me të njëjtat kritere ishin hapja dhe ndërveprimi islam me trashëgimitë e Indisë ku mysliamanët morën astronominë e Indisë dhe aritmetikën e saj, por nuk morën filozofinë dhe as fetë e saja. Të njëjtat kritere sunduan hapjen e madhe të civilizimit islam ndaj trashëgimisë greke. Ata morën prej Greqisë shkencat natyrore dhe eksperimentale, por nuk e morën idhujtarinë e Greqisë. Me të njëjtat kritere ishte hapja e civilizimit evropian - në kohën e rilindjes së saj - ndaj civilizimit islam kur ajo mori shkencat eksperimentale dhe metodologjinë empirike si dhe mirësitë e Islamit, por ajo nuk i mori sistemin e vlerave islame, as parimet e besimit islam dhe as filozofinë e shkencës të mysliamanët.

Filozofia e Islamit u dallua nga të tjerat joislame lidhur me shqyrtimin ndaj legjislacioneve, popujve dhe medhhebeve fetare dhe në marrëdhëniet me ato legjislacione, popuj e medhhebe, u dallua me qëndrimin e saj tek e Mesmja e Artë e cila përcakton se Feja e Zotit është një prej Ademit a.s deri te Muhamedi a.s. Legjislacionet qiellore janë të shumëllojshme me shumëllojshmërinë e popujve të profetësive dhe të mesazheve në kuadrin e unitetit të besimeve të kësaj feje të vetme hyjnore. Në këtë filozofi u bë realitet uniteti fetar me dallueshmërinë në legjislacionet fetare gjithashtu. Kjo filozofi islame, në këndvështrimin e saj ndaj atyre që kanë fe tjetër, provoi se Islami është "Revolucion Reformator" dhe "Reformim Revolucionar", që e tejkaloi njohjen e tjetrit, pranimin dhe përforcimin e tij, dhe kaloi deri aty ku ky "tjetri në shariat" të jetë pjesë e vetë fesë së vetme. Kjo ndodhi për herë të parë në historinë e marrëdhënieve mes bijve të feve dhe të civilizimeve, dhe vetëm Islami është ai që nisi me të udhëtimin e bërjes së tjetrit një pjesë prej esencës fetare dhe përcaktoi për të tjerët të njëjtat të drejta e detyra në shtet e në Umet, *"...dhe ata do të gëzojnë atë çfarë gëzojnë mysliamanët, dhe do të jetë kundra tyre ajo çfarë është kundra mysliamanëve..."*. Madje Islami e bëri tjetrin me fe ndryshe një pjesë prej farefisit kur e ngriti familjen - dhe jo vetëm Umetin - mbi larinë fetare, saqë gruaja Kitabijeh, prej pasuesëve të Shkrimeve të Shenjta, u bë banesë tek e cila banon mysliamani dhe vendi i dashurisë dhe i miqësisë së tij; dhe midis atyre të dyve është një ujd e besëlidhje e natyrshme, sikur ata të dy të ishin një person i vetëm që i bashkon një veshje e vetme, **"Ato janë veshje (vend prehjeje) për ju, siç jeni edhe ju veshje për ato"**. (El-Bekare, 2:187).

Meqenëse filozofia e Islamit, ndërsa njihet me idealen,

nuk i neglizhon elementët përbërës të "Realitetit", ajo u dallua me drejtësinë, e cila nuk i vendos të gjithë pasuesit e Shkrimeve të Shenjta në një shportë të vetme dhe në një kategori të vetme, por bëri dallim mes grupeve të tyre sipas qëndrimit të çdo grupi prej "Fjalës së përbashkët e të drejtë", që është dallimi në legjislacione në kuadrin e unitetit të fesë: *"Pejgamberët janë bijtë e një burri të vetëm; feja e tyre është një, kurse nënat e tyre janë të ndryshme."* (Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi). Thuaj: **"O Ithtarë të Librave të Parë! Ejani te një fjalë që është e drejtë dhe e përbashkët mes nesh dhe jush: Që të mos adhurojmë askënd përveç Allahut, që të mos i vëmë shokë Atij në adhurim, dhe që asnjë prej nesh të mos marrë të tjerë për zot përveç vetëm Allahut"**. Pastaj, në qoftë se ata largohen, thuaju: **"Dëshmoni për ne se jemi mysliamanë"**. (Al 'Imran, 3:64). Ithtarët e Librit, **"Jo të gjithë ata janë njësoj: Ka prej atyre nga popujt e Librave të Parë që janë për të drejtën, ata lexojnë vargjet e Allahut gjatë orëve të natës dhe bien në sexhde. Ata besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit; ata urdhërojnë atë që është e drejtë, dhe ndalojnë atë që është e padrejtë; dhe shpejtojnë në të gjitha punët e mira. Dhe vërtet këta janë prej të drejtëve"**. Dhe çfarëdo mirësie që ata bëjnë, asgjë nuk do t'u mohohet. Dhe Allahu është i Gjithëditur për të përkushtuarit". (Al 'Imran, 3:115). Nuk do të ishte kurrë e drejtë që të barazosh mes atyre sytë e të cilëve derdhin lot nga ajo që njohën prej së vërtetës dhe mes atyre që hynë në një lloj shirku ose kufri, në të përshkruarit ortakë me Zotin ose në mohim. **"Sigurisht që mohuan ata të cilët thanë: "Allahu është Mesihu (Isai), biri i Merjemes". Por Mesihu u tha: "O bijtë e Israilit! Adhuroni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj! Nuk ka dyshim se kushdo që i vë shok në adhurim Allahut, atëherë Allahu e ka bërë të ndaluar Xhenetin për të dhe vendbanimi i tij do të jetë Zjarri, dhe për të padrejtët nuk do të ketë asnjë ndihmues"**. (El-Maide, 5:72).

Islami, me këtë dallim mes grupeve të Ithtarëve të Librave të Parë dhe me drejtësinë në dallimin e tij mes qëndrimeve të tyre ndaj "Fjalës së përbashkët e të drejtë", ka vënë llogarinë e të gjithë asaj vetëm tek Allahu në Ditën e Gjyqit. Ndërsa në dynja, në shtet dhe në Nderimin Hyjnor për bijtë e Ademit në përgjithësi, Islami ka përcaktuar e vendosur të drejta e detyrime për të gjitha këto grupe, të drejta të tilla që ai i ka vendosur edhe për besimtarët mysliamanë, nëpërmjet të gjithë Librave dhe të gjitha profetësive dhe mesazheve dhe nëpërmjet mënyrës që e shprehu Profeti Muhamed a.s. në "Konventën" e tij për të krishterët e Nexhranit dhe për të gjithë ata që përqafojnë fenë e krishterë, *"...dhe ata do të gëzojnë atë çfarë gëzojnë mysliamanët, dhe do të jetë kundra tyre ajo çfarë është kundra mysliamanëve..."*.

Këto ishin boshtet e bashkëjetesës me fetë e tjera në Kur'anin Fisnik dhe në zbatimin profetik të këtij Kur'ani Fisnik.

A lejohet surrogacia në Islam?



Mëmësia surrogate është një aktivitet që bie ndesh me legjislacionin, normat morale dhe aspektin njerëzor në besimin islam. Për këtë arsye të gjitha qendrat e opinioneve fetare në vendet islame, si ajo e Egjiptit, Emirateve të Bashkuara, Arabisë Saudite, Jordanisë dhe Turqisë, kanë deklaruar se praktika në fjalë është kategorikisht i ndaluar.

Shkaqet janë cituar si më poshtë:

Në Kuranin e Shenjtë Zoti është shprehur: Allahu i ka krijuar për ju gratë nga lloji juaj e nga gratë tuaja ju jep djemtë e nipat... (Nahl, 16:72) Ky ajet tregon mënyrën natyrale të ndërtimit të brezave njerëzore. Gjithashtu në mënyrë shumë të fortë kërkon që njerëzit të qëndrojnë larg marrëdhënieve intime pa kurorë, sepse kjo përzier brezat dhe prish rendin shoqëror (Isra, 17:32). Dhe ka vlerësuar ata që ruajnë nderin, duke mbajtur të shëndetshme shoqërinë juridikisht dhe moralisht (Muminûn 23:5-7). Nisur nga këto parime citojmë:

1 – Arsyeja më e rëndësishme pse zëvendësimi nuk është i lejuar në aspektin e ligjit islam është se kjo praktikë shkakton konfuzionin e prejardhjes dhe i hap rrugën mundësisë së tradhtisë bashkëshortore.

2 – Kjo praktik bie ndesh me dinjitetin që Zoti i ka dhënë njeriut. Ky dinjitet ruhet sidomos duke respektuar njeriun nga aspekti i tij fizik. Nisur nga kjo një grua nuk ka të drejtë të japë me qira gjymtyrët e saj.

3 – Feja islame në raste domosdoshmërie lejon praktikën “in vitro” brenda disa kriterëve të caktuara jo fort të vështira për tu plotësuar. Për sa kohë që do të këtë hapësira që nuk bien ndesh me frymën e fesë, Islami do të jetë pro mundësive të reja për të mundësuar jetë të reja dhe për ta mbrojtur atë. Por nëse këto kushte nuk janë të sigurta, si dhe janë evazive dhe të hapura për abuzim, atëherë feja islame është kundër.

4 – Kërcënimi i dinjitetit të gruas si dhe i fëmijës janë probleme esenciale në praktikën e surrogacisë. Gruaja nga nënë që lidhet me trup dhe me shpirt me qenien që mbart në trup, kthehet në një mjet që ngarkon e shkarkon krijesa. Kjo shkel dinjitetin e saj në mënyrë shumë të qartë. Së dyti, fëmija për të cilin është marrë një vendim për tu mbartur nga një grua që nuk është nëna e tij, përbën një metodë jashtë normalitetit njerëzor, proces i cili mund të jetë i papranueshëm për vetë fëmijën. Në këtë rast ai është vënë në një situatë pa zgjidhje, e cila mund t'i shkaktojë atij pasoja të rënda psikologjike. Sipas fesë islame askush nuk ka të drejtë t'i shkaktojë dikujt tjetër të tilla situata.

Në tërësi bëhet fjalë për shkelje të normave të fesë, privatësisë, martesës, mbrojtjes së pasardhësve dhe personalitetit, sepse cenon disa parime thelbësore në lidhje me mbrojtjen e shëndetit mendor dhe fizik të njeriut, si dhe dinjitetin njerëzor. Allahu di gjithçka më së miri.

Disa çështje rreth pushimeve



Ja dhe shkolla mbaroi për këtë vit. Bashkë me përfundimin e një viti shkollor, prindërit i shqetëson më shumë mendimi se si fëmijët do t'i kalojnë këto pushime.

Çdo prind dëshiron që fëmija i tij të lexojë, të punojë ekstra në lëndët ku ka çaluar gjatë vitit shkollor dhe t'i shfrytëzojë pushimet në mënyrën e duhur, por, në të vërtetë, ata përballen me dembelizmin, përtacinë, varësinë ndaj televizorit dhe pajisjeve teknologjike. Jo çdo fëmijë mund të shprehë dëshirën të ndjekë programin e dëshiruar të prindit. Prandaj, para fillimit të sezonit veror, është shumë e rëndësishme të flisni dhe të diskutoni bashkë me fëmijët tuaj (për/rreth) mënyrën se si do ta shfrytëzojnë verën dhe planin që duhet të bëni në mënyrë që këto 3 muaj të gjatë të mos shndërrohen në tre muaj, të cilët nxisin mërzinë dhe depresionin.

Pushimet verore mundësojnë zhvillimin, zbulimin e aftësive, maturimin e fëmijëve. Një kohë kaq e bollshme duhet kaluar me një plan, sa efektiv, aq dhe produktiv. Më poshtë do të japim disa këshilla për prindërit:

Pikë së pari, nxiteni fëmijën të ndajë me ju ndjenjat pozitive dhe negative të lidhura me dëftesën. Përpikuni të jeni të sigurtë me të dhe mos përdorni fjalë apo ton ofendues nëse ai ka dalë me rezultate të padëshiruara.

Ndërtoni empatinë e duhur dhe kuptoni ndjenjat e tij. Mos kaloni shumë kohë duke vlerësuar dëftesën, sepse kjo do të krijojë një ndjenjë presioni te fëmija.

Diskutoni me fëmijën se si mendon t'i shfrytëzojë pushimet verore dhe cilat janë fushat ku mendon të fokusohet.

Bëjani të ditur se ju jeni të gatshëm t'i jepni ndihmën dhe mbështetjen e kërkuar.

Përpikuni të njihni fëmijën tuaj, të vlerësoni objektivisht anën e tij pozitive e negative, dhe të arrini që t'ia transmetoni këtë edhe atij. Për këtë arsye përgatisni mundësinë ku ai të shpalosë aftësitë dhe talentin.

Mos bëni plan në vend të fëmijës tuaj, por planifikoni bashkë me të. Shumë familje përjetojnë debate në lidhje me përcaktimin e një plani veror. Zakonisht prindërit mbajnë dy qëndrime, atë autoritar, ku bëhet çfarë mendon e thotë prindi, dhe atë shumë demokratik, ku vendimi lihet në dorë të fëmijës. Në këtë rast debatet përfundojnë me fitoren e njëres palë dhe humbjen e tjetrës. Shtëpia nuk duhet të kthehet në një fushëbetejë ku shpaloset autoriteti dhe fuqia, por një vend ku ndahet dashuria dhe përgjegjësitë.

Përpikuni të gjeni një rrugë të mesme ku të harmonizohen



dëshirat tuaja dhe të fëmijës. Dhe mos harroni: Përpilimi i një plani është shumë herë më efektiv se indiferentizmi dhe mos-përpilimi i tij.

Ja disa këshilla të arta:

Dëftesa të mos vendoset në qendër të vëmendjes: Pas vlerësimit objektiv të dëftesave të dobëta fëmijëve u duhet dhuruar dashuri dhe siguri. Qëndroni larg krahasimit të fëmijës suaj me fëmijë të tjerë. Fëmijët që kanë marrë një dëftesë shembullore duhen falënderuar për përpjekjet e bëra.

Të mos bëhemi robër të internetit: Pajisjet teknologjike si: telefoni, tableta, kompjuteri, etj., nuk duhen përdorur në mënyrë të pakontrolluar. Mungesa e kontrollit sjell varësi dhe humbje përqendrimi të fëmijët. Nëse prindërit nuk bëjnë një plan veror, atëherë fëmijët do ta kalojnë të gjithë verën para televizorit apo internetit. Në këtë mënyrë do të pengohet zhvillimi mendor dhe fizik i tyre dhe do t'i hapet rrugë shumë problemeve.

Të vlerësohen kurset e gjuhëve të huaja: Regjistrimi në një kurs gjuhe do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e fëmijëve. Krahas kësaj, këto kurse ndikojnë në përdorimin

efektiv të kohës dhe planifikimin më frytdhënës të verës.

Të përpilohet një listë e librave që mund të lexohen: Lista duhet të përpilohet duke u bazuar në nivelin dhe dëshirat e fëmijës. Nxitja e fëmijëve në zbatimin e përmbajtjes së kësaj liste përbën një hap të rëndësishëm. Nëse është e mundur, leximi i librave të bëhet familjarisht, duke bërë analizën dhe diskutimin rreth vendeve më të pëlqyera. Mund të caktohen orare të veçanta të leximit bashkë si familje.

Forcimi i marrëdhënieve familjare: Kalimi i pushimeve verore pranë të afërmeve apo kushërinjve mund të ndikojë pozitivisht në forcimin e marrëdhënieve familjare. Duke u bërë vizita familjarëve, fëmijët arrijnë të kuptojnë shpirtin e familjes dhe të zbulojnë rëndësinë e bashkimit.

Të organizohen shëtitje: Vizita e qyteteve të ndryshme apo edhe shteteve, nëse mundësitë ekonomike e lejojnë, gjallëron dhe pasuron mendjen e fëmijëve me vlera kulturore e historike.

Të frekuentohen kurse sportive, muzike apo pikturë: Kurset verore mundësojnë zbulimin e aftësive dhe talenteve të fëmijëve dhe ndihmojnë zhvillimin e ndjenjave estetike. Për këtë mund të shihen kurset e muzikës, pikturës, etj.

Krygëzimi i gytetërimeve **probleme dhe perspektiva**

Vështirësia nuk qëndron në të kuptuarit e fesë dhe gjeografisë. Unë mendoj se vështirësia është në të zbuluarit e asaj diçkaje që është më shumë se sa fe në Islam dhe gjeografi në Perëndim, sepse Islami është fe më shumë se sa fe dhe Perëndimi është gjeografi më shumë se sa gjeografi. Unë besoj se kjo "diçka më shumë se sa fe dhe gjeografi", është ajo që i bën Islamin dhe Perëndimin të tërhiqen drejt njëri-tjetrit dhe të jenë në garë me njëri-tjetrin.

Duke qëmtuar në këtë 'diçka' të mistershme, që është "diçka më shumë se sa Islam", disa të shkolluar, shpesh e humbasin nga shikimi objektin e studimit të tyre. Të verbuar nga ambicia për të qenë të kohës, disa të shkolluar të Perëndimit orvaten të japin mendime të paragjykuara në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me myslimanët. Ata dëshirojnë të na mësojnë, se politikat janë diçka më shumë se sa feja islame, por duke harruar faktin se Islami është diçka më shumë se sa vetë politika. Pra, të reduktosh Islamin në gjykime politike, është një çoroditje, si të reduktosh politika vetëm me problemet e Islamit. Islami është politikë më shumë se politika, siç është në të njëjtën kohë më shumë fe se feja.

Unë mendoj se është më shumë kjo "diçka më shumë e Islamit" se sa politika primitive, që mungon të shihet në mediat apo kulturën e Perëndimit. Sadam Huseini është një mysliman, aq sa është Hitleri një i krishterë; Karaxhiçi është i krishterë, aq sa është Osama bin Laden mysliman. Sidoqoftë, në këtë vizion primitiv, Hitleri nuk është një i krishterë fashist. Ai s'është veçse një ndër fashistët më të këqij në histori. Karaxhiçi nuk është një i krishterë kriminel lufte. Ai s'është veçse një ndër kriminelët më të këqij të luftës në ish-Jugosllavi. Nga ana tjetër, Sadami nuk është vetëm një ndër shtetarët më të këqij të historisë. Ai është pikërisht myslimani diktator. Dhe Osama bin Laden s'është veç një ndër luftëtarët vullnetarë botërorë, por ai është terroristi islamik i vërtetë.

Myslimanët e mbarë botës janë përditë të bombarduar prej medias perëndimore, veçanërisht, sepse adresa e atyre që akuzohen për terrorizëm janë në trajtën pavetore. Përderisa Islami nuk ka një adresë personale, kjo do të thotë se çdo gjë dhe kushdo që ka lidhje me idenë fisnike të Islamit, është i akuzuar edhe pa një provë të vërtetimit të fajësisë. Do t'u dëshiroja disa njerëzve të medias perëndimore të ishin në rrobat e myslimanit



vetëm një minutë, që të shikonin se si dikush e ndjen veten të mundshëm për t'u shndërruar në një tabelë qitjeje të akuzave për terrorizëm islamik. Unë mendoj, se pas kësaj, ata kurrë nuk do të stigmatizojnë më me damkën e terrorizmit islamik.

Madje, edhe nëse themi se Perëndimit i pëlqen ta mbajë Islamin nën një provë të përhershme pa një verdikt të qartë për fajësi, nuk është ende e falshme për të ofruar një mbrojtje të dobët për Islamin. Historia ka treguar se mirëqenia e Islamit është më mirë të kryhet me një vetëdhënie provash, se sa me një britmë apologjike (mbrojtëse). Islami i ka rezistuar disa keqinterpretimeve myslimane dhe po kështu do t'u rezistojë edhe atyre perëndimore.

Unë vërej se marrja e Islamit dhe Perëndimit vetëm me terma të problematikës dhe lidhjeve midis të madhit Perëndim dhe Lindjes së gjerë islame, nuk na ndihmon të kuptojmë problemet dhe të ardhmen e Islamit në vetë Perëndimin, jo si diçka që është e importuar, por si diçka që ka lindur në Perëndim. Flas për myslimanët natyrorë të Perëndimit, ata që historikisht janë europianë dhe ata që kanë lindur në Europë. Do të doja të ndaja mendimin dhe reflektimin tim për problemet e Islamit,

të ardhmen dhe qytetarinë e tij në Europë, si një port i jetës njerëzore, me problemet dhe të ardhmen e Islamit dhe të Perëndimit në Europë.

Më lejoni të them se Europa nuk është Darul Islam (shtëpia e Islamit), por nuk është as edhe Darul Harb (shtëpia e luftës). Unë besoj se Europa është Darus Sulh (shtëpia e pajtimit), shtëpia e kontratës sociale. Nuk është shtëpia e Islamit, sepse myslimanët nuk përbëjnë shumicën e banorëve dhe vendeve të saj, por edhe sepse Ligji Islam nuk mund të implementohet plotësisht.

Ajo nuk është shtëpia e luftës, sepse disa aspekte të ligjit islam mund të implementohen. Megjithatë Europa është shtëpia e pajtimit, sepse të jep mundësinë të jetosh në pajtim me Islamin në kuadrin e "Kontratës Sociale", si principe që individët e lirë dhe racionalë, të nisur nga interesa personale, do ta pranonin në një pozitë fillestare të barazisë, si përkufizim të termave të shoqërizimit të tyre.

Nuk është e vështirë të provohet ideja e një kontrate, qoftë sociale apo tjetër, është mëse e legjitimuar në Islam. Ne kemi me shumicë dokumente doktrinale dhe historike, të cilat tregojnë për konceptin e Sulh-it (paqe,

“ri”pajtim, zgjidhje), si një kundërshti të konceptit të Harb (konflikt, përlëshje, acarim, luftë, etj.).

Ideja e vërtetë e Islamit është paqja me Zotin, me të Dërguarin e Tij dhe me sundimin e ligjit. “Zoti ju thërret në shtëpinë e paqes” (10:25). “Shërbëtorë të Zotit janë ata, të cilët vërtiten kokulur, të përlulur në këtë rruzull dhe që kur injoranti u drejtohet atyre, ata thonë: “Paqe”” (25:63). “Nuk është e përshtatshme për një besimtar, grua qoftë apo burrë, që atëherë kur diçka është e vendosur prej Zotit dhe të Dërguarit të Tij, të ketë një opinion të vetin, nëse kushdoqoftë nuk i bindet Zotit dhe të Dërguarit të Tij, do të thotë që ai paska zgjedhur rrugën e gabuar, me të vërtetë” (33:36). “Secilit prej jush i kemi përshkruar një Ligj dhe një Rrugë të hapur. Nëse Zoti megjithatë do të kishte pasë dëshirë, Ai do të mund t’ju bënte një popull të vetëm, por (plani i Tij është) dëshiron t’ju vërë në provë në atë çka ju ka ofruar... Qëllimi i të gjithë juve është Zoti. Është Ai që do t’ju tregojë juve të vërtetën e gjërave për të cilat keni kundërshtime ndërmjet jush” (5:51).

Është në frymën e këtyre ajeteve kuranore, që i Dërguari i Zotit a.s. ka realizuar traktate (pajtimi apo zotimi) me politeistët, të krishterët dhe çifutët në Medinë, si edhe me fqinjët mbretër të Abisinisë, Persisë apo Bizantit. Kalifati i Rashidinëve ka ndjekur pikë për pikë shembullin e të Dërguarit a.s., shembull ky i ndjekur prej sundimtarëve të mbarë myslimanëve gjatë gjithë historisë së Islamit. Ky fakt historik i Kontratës Shoqërore, i nisur prej myslimanëve mbarë kundërsht kombeve apo kulturave të tjera, ka qenë mësimi i dokumentuar prej Dr. Muhamed Hamidullah në librin e rrallë të titulluar “Grup dokumentesh politike të epokës së Profetit dhe Kalifatit të Rashidinëve”.

Ne mund të shpreheshim se një kontratë burrash nuk është ligj i natyrës, por diktati i arsyes, sidoqoftë kjo marrëveshje, është vullneti i besimit. Kështu pra, që ne e konsiderojmë myslimanin si një njeri besnik ndaj Zotit, si një akt vullneti për fenë e tij, që do të thotë kushtetutë. Ne e përkufizojmë qytetarin si një njeri me detyrime shtetërore, pra si një akt të diktatit të arsyes së tij, pra të pajtimit të tij me marrëveshje, njeri që mund të japë zemrën e tij për Zotin dhe të marrë prej Tij sigurinë e brendshme.

Me kontratë, ai i jep shtetit arsyen e tij dhe merr prej tij sigurinë sociale, si banor i një qyteti apo fshati. Njeriut i jepet e drejta për të pasur privilegje dhe e drejta si një njeri i lirë. Ai është pjesëtar i një shteti, një njeri i lindur apo i natyralizuar, që i deklaron besnikërinë e tij një qeverie, e cila nga ana

e saj ka për detyrë t’i sigurojë të drejtat për jetën, fenë, lirinë, pasurinë dhe dinjitetin.

Më lejoni të jem i qartë këtu: të mirëkuptohesh, nuk dotë thotë të pranosh. Në të kundërt, mosmirëkuptimi të çon në pranimin e gjërave, që mund të hidheshin

poshtë prej shpirtit të marrëveshjes po aq mirë, sa edhe mund të hidheshin poshtë gjëra që mund të pranoheshin prej forcës së kontratës. Megjithatë, mosnjohja e realitetit të shoqërisë europiane në dimensionet e saj të ndryshme, na bën të paaftë të dallojmë të mirën nga e keqja, të nevojshmen nga e panevojshmja e prodhimeve europiane. Unë tentoj të besoj se Europa (apo Perëndimi në përgjithësi) ka më shumë njohuri për myslimanët që më vonë t’i pranojë ata, në të kundërt, myslimanët kanë shumë më pak njohuri për Perëndimin dhe kështu që janë më pak të gatshëm për ta pranuar. Ky është dallimi bazë midis afrimit europian për Islamin dhe afrimit mysliman për Europën. Pra, europianët t’i pranojnë myslimanët siç janë dhe myslimanët të mbeten në stadin e tyre të njohjes për Europën. Europa është gati të tolerojë Islamin në shtëpinë e saj, por nuk është akoma e gatshme të pranojë Islamin në jetën politike, kulturore dhe sociale të saj. Nga ana tjetër, myslimanët janë gati ta pranojnë Europën ashtu siç është, por nuk janë duke bërë ndonjë gjë të mjaftueshme për të rritur njohjen e tyre për ambientin politik, kulturor e shoqëror europian, me qëllim ndryshimi të pozicionit të tyre në shoqërinë europiane.

Nëse do të pranonim Shtëpinë e Pajtimit si një koncept tonin për Europën, sipas termave të “një myslimani të vërtetë dhe qytetari të mirë europian”, vetëm atëherë do të mund të njihnim se cilat janë rrugëdaljet që do të mund të kishin të bënin me veten tonë për të gatuar konceptet praktike. Vallë, a do të mund të njihnim problemet që mund të krijohen prej disa lloj tensionesh mes Islamit alla europian dhe qytetarisë? A janë ato vallë politike apo ekonomike, kulturore apo fetare? Unë besoj se do të ishte korrekte të thonim se problemet janë të tëra fetare. Pra, politikisht, myslimanët në Europë do të duhej të dinin se çfarë përfaqësojnë të drejtat njerëzore për komunitetin e tyre. Do të duhet të insistonin për të shkundur paragjykimet që ekzistojnë te publiku europian për Islamin dhe myslimanët e të krijuar prej masmedias politike europiane.

Me këtë nënkuptoj prirjen dhe qëndrimin antiislam, si një rezultat të intolerancës politike dhe urrejtjes raciale. Ne duhet ta mësojmë Europën që të pranojë vlerat islame dhe të çmojë kontributin, që punëtorët dhe intelektualët myslimanë japin në ndërtimin e një Europe të lulëzuar dhe të lirë. Nuk është vetëm në planin historik që Europa i ka borxh myslimanëve lirinë dhe lulëzimin e saj, por është gjithashtu edhe kontributi i tanishëm i myslimanëve për zhvillimin e saj, që na jep të drejtën të shpallim që Europa na ka një borxh të madh. Ekonomikisht, ne duhet të kërkojmë shanse të barabarta për një

lulëzim ekonomik të komunitetit mysliman në Europë.

Për sa i përket problemeve fetare, ato varen në një masë të madhe në zgjidhjen e të lartpërmendurave zgjidhje politike, ekonomike dhe kulturore. Feja jonë është rruga e jetës sonë. Megjithëkëtë, problemet fetare nuk mund të izoloohen prej jetës sonë. Ndërtimi i një xhamie në Europë është një problem fetar, por ai nuk mund të zgjidhet pa një vendosmëri politike të qeverisë europiane, nuk mund të mbahet pa një zhdërvjelltësi ekonomike të komunitetit mysliman, ai nuk mundet t'u shërbejë qëllimeve të tij edukuese pa lehtësitë e duhura.

Çështjet e myslimanëve në Europë nuk mund të kufizohen vetëm tek ato fetare, por mund të shtrihen po kaq edhe tek ato shoqërore. Feja jonë mund të trajtohet në mënyrë të natyrshe dhe legale si të gjitha kulturat e tjera të Europë, sipas parimit të lirisë së ndërgjegjes. Për fat të keq, Islami akoma nuk është natyralizuar në Europë. Ai ende ka një status të çuditshëm, apo një status të veçantë, që e toleron, por nuk e ka pranuar si një përfaqësi e barabartë në fushën e trashëgimisë shpirtërore europiane, pavarësisht faktit që ai qëndron sot për sot si një besim i dytë pas Krishtërimit në shumë vende europiane.

Myslimanët europianë sot janë duke u përballur me vështirësi të mëdha në ruajtjen e identitetit të tyre prej mungesës së vullnetit të disa qeverive europiane, me qëllim sendërtimin e nevojave të tyre fetare dhe të drejtave shoqërore. Ata presin të jenë të integruar në shoqërinë europiane, shumë shpesh për të mos humbur identitetin e tyre mysliman. Në përgjithësi, prej medias europiane del përshtypja sikur një mysliman, për të qenë qytetar i mirë europian, duhet të mohojë origjinën e tij myslimane, apo të marrë përsipër (sikur të jetë ai fajtori) barrën e gjithçkaje që ndodh në botën myslimane.

Kjo ndodh, sepse nga kjo përshtypje, del që çështja e myslimanëve në Europë nuk është vetëm fetare, në kuptimin e personalitetit etik dhe moral mysliman, por në shumë raste, gjendja e tyre është e mbingarkuar aq shumë politikisht, sa rëndom dhe përherë ata jetojnë nën presionin e pasigurisë dhe frikës. E megjithëkëtë, Islami mund të depolitizohet në kuptimin e të larguarit nga lokalizmi e të shfaqjes siç është, një fe universale, që ka qëllimet e veta t'u mësojë pasuesve besimin e mirë të jetesës në një shoqëri globale. Kjo, natyrisht, nuk do të thotë se myslimanët nuk mund të mirinformohen për politikën e shoqërisë globale. Përkundrazi, myslimanët mund të jenë mjaft mirë të pajisur me njohurinë e një politike globale, në mënyrë që të jenë të aftë të ruajnë besimin e tyre nga politizimet e këqija.

Duke thënë këtë, ne erdhëm tek më e rëndësishmja çështje për Islamin në Europë, të emërtuar 'problemi i përfaqësimit dhe i institucioneve'. Së pari, na duhet

të dimë se me anë të një vlerësimi të

përafërt, tridhjetë milionë myslimanë jetojnë në Europën e sotme. Ata paraqesin tre grupe të ndryshme: 1) vendasit; 2) emigrantët; 3) të lindurit në Europë. Me vendas nënkuptojmë myslimanët, të cilët kanë një të kaluar të gjatë historike në Europë, siç janë myslimanët e Bosnjes, Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, Bullgarisë, etj.. Me emigrantë, nënkuptojmë myslimanët, të cilët kanë emigruar në Europë si studentë apo punëtorë dhe që janë sistemuar përgjithmonë në Angli, Gjermani, Francë, etj. Dhe grupi i të lindurve në Europë, janë brezi i ri i gjeneratave, të lindur prej prindërish emigrantë. Të tre këto grupe kanë të përbashkët Islamin. Ata ndryshojnë, sidoqoftë, në eksperiencën e tyre njerëzore dhe jetën e ardhshme.

Myslimanët vendas kanë në përvojën e tyre një barrë të rëndë historie dhe presin mbështetje për përballimin e betejës së tyre për vazhdimësinë e tyre kulturore e fetare në Europë. Myslimanët emigrantë janë duke bërë përpjekje të mëdha për të stabilizuar vetveten në Europë dhe janë në pritje të tejkalimit të statusit të tyre si të huaj në të. Myslimanët e lindur në Europë janë në gjendjen e një sfide për ruajtjen e identitetit të tyre islam, në një thirrje për sfida me politikën, ekonominë

dhe ambientin kulturor europian dhe presin që dikush t'u thotë atyre se si të jenë kryelartë për besimin e tyre dhe për lindjen e tyre në Europë.


Çka mund të jetë si përfundim? Ajo që vlerat e përbashkëta të Islamit mund të bëhen një bazë e përbashkët për të gjithë myslimanët në Europë. Unë besoj se tani është koha që të vlerësojmë sa më seriozisht rrugën e institucionalizimit të Islamit si një fe universale dhe myslimanët si qytetarë universalë.

Unë shpresoj që të jetë tepër e qartë për këdo, se një paraqitje voluntariste e Islamit dhe e myslimanëve në Europë, është çoroditëse, si edhe çdo gjë tjetër që drejtohet kundër dinjitetit mysliman dhe paqes europiane.

Nuk është e mjaftueshme që Europa të mirëpresë praninë e Islamit në tokat e saj. Myslimanët presin më shumë se kaq. Ata presin që prania e tyre të legalizohet, në kuptimin e krijimit të një klime politike dhe ekonomike, që t'i mundësojë çdo myslimani europian, të tregojë vetveten përpara institucioneve dhe që të ketë si mbështetje qeveritare, po ashtu edhe mirëpranim prej publikut. Sepse deri më tani, jemi të ofenduar nga insistimi i medias europiane në paraqitjen e Islamit në Europë përmes figurës së terroristëve.

***Ish-kryemyfti i Bosnje-Hercegovinës**

Detyrat në lidhje me pasurinë



Pasuria në një pikëpamje është e mirë, e në një pikëpamje tjetër është e keqe. Është sikur gjarpri. Mjeshtri e kap gjarprin dhe prej saj bën kundërhelmin, kurse personi i pavëmendshëm e kap gjarprin, e gjarpri e mbyt. Dhe askush nuk mund t'i shpëtojë helmit të pasurisë, përveç atij që ndjek këto pesë detyra:

Detyra e parë është të dihet se cili është qëllimi i pasurisë, pse u krijua ajo, pse nevojitet; si fitohet, të mos grumbullohet më shumë sesa ka nevojë, e as të mos harxhohet pa nevojë.

Detyra e dytë është t'i kushtohet vëmendje mënyrës së fitimit. Largimi nga harami i qartë dhe nga pasuria e sulltanëve, që në përgjithësi njihet si haram, largimi nga angazhimi në mekruh, largimi nga gjërat që dëmtojnë njerëzillëkun, siç janë dhuratat që kanë erën e ryshfetit, si edhe nga lypja me poshtërim.

Detyra e tretë është shuma që do të fitojë. Të mos jetë as shumë, por as pak - vetëm sasia e duhur, e kjo sasi përcaktohet nga nevojat e secilit. Ajo që ne e quajmë nevojë përbëhet nga ushqimi, veshmbathja dhe strehimi. Secila prej tyre ka tri shkallë: e ulët, e mesme dhe e lartë. Kur njeriu është i kënaqur me shkallën e ulët dhe sasinë minimale të nevojës, konsiderohet si njohës i hakikatit. Nëse e kalon kufirin, vendi i tij do të jetë në Havije, shtresa më e ulët e xhehenemit.

Detyra e katërt është t'i kushtohet vëmendje origjinës së pasurisë. Gjatë dhënies, njeriu duhet të ketë kujdes nga shpërdorimi dhe koprracia, si dhe ta harxhojë ku duhet pasurinë që e fiton hallall. Nuk ka dallim mes fitimit të padrejtë dhe shpenzimit të padrejtë. Dënimi për të dyja është i njëjtë.

Detyra e pestë është të kesh nijet të mirë kur merr pasuri, kur jep, kur e braktis, kur ia siguron jetesën dikujt. Kur merr pasurinë, duhet të ketë nijet që pasuria ta ndihmojë në ibadet, kur e braktis, të ketë nijet që ta braktisë dynjallëkun me zemër dhe për shkak që e përbuz pasurinë. Nëse vepron kështu, pasuria e tij nuk do ta dëmtojë.

Prandaj, Aliu r.a., ka thënë: "Nëse personi ka pasurinë e gjithë botës dhe ka nijet **rizanë** e Allahut, kjo pasuri nuk e dëmton, ai është **zahid**," e dikush tjetër ka thënë: "Edhe nëse personi sakrifikon gjithë pasurinë e botës, por nuk e bën nijet për

rizanë e Allahut, ai nuk është zahid."

Prandaj, të gjitha veprimet e tua le të jenë për rizanë e Allahut dhe drejt një qëllimi që ndihmon ibadetin tënd. Veprimet që duken më të largëta nga ibadeti janë ngrënia, pirja dhe kryerja e nevojës. Megjithatë, këto ndihmojnë ibadetin. Prandaj, nëse qëllimi i të ngrënit apo i prishjes së abdesit është për shkak të ibadetit, edhe këto veprime konsiderohen si ibadet për ty. Kështu duhet të jetë nijeti yt edhe për rrobat që i vesh për t'ju mbrojtur nga nxehtësia a të ftohtit, për shtratin dhe enët. Sepse nga aspekti fetar, njeriu ka nevojë për të gjitha këto. E për tepricën përtej nevojës - atë duhet ta bëjë nijet për t'ia dhënë dikujt që ka nevojë, dhe dikush kur ka nevojë për të, duhet t'ia japë.

Pra, ai që vepron kështu, ka marrë kundërhelmin nga gjarpri i pasurisë dhe është i mbrojtur nga helmi i tij, prandaj bollëku i pasurisë nuk e dëmton.

Mirëpo, këtë lloj sjelljeje mund ta bëjnë vetëm njerëzit e zgjedhur që e kuptojnë mirë fenë dhe janë të palëkundur në besimin e tyre. Nëse njerëzit e rëndomtë i shikojnë njerëzit si këta dhe përpiqen ta shtojnë pasurinë e vet, duke menduar se edhe ata janë si këta, mashtrohen dhe duken si një fëmijë që kap gjarprin duke e parë të rriturin që e di çka është helmi dhe kundërhelmi si e mban gjarprin në dorë. Fëmija mendon se personi e mban gjarprin për shkak të lëkurës së tij të butë, por gjarpri e kafshon dhe e mbyt. Njerëzit e rëndomtë janë të tillë; ata nuk e dinë si të zgjedhurit; për çfarë është pasuria, në çfarë mënyre fitohet dhe për çfarë qëllimi duhet të ruajnë pasurinë. Ata e dinë se gjarpri e mbyt njeriun duke e helmuar dhe ndonjëherë njeriu e mbyt gjarprin, por nuk e dinë se njeriun e mbyt edhe pasuria. Poeti e ngjasoi dynjanë me një gjarpër dhe tha:

"Kjo botë është si gjarpri që helm në trup të fut,

ani pse lëkura i duket e mirë, e butë."

Ashtu siç është e pamundur që një i verbër t'i ngajë një personi që syri i shih gjatë kalimit të maleve, udhëtimit në brigjet e detit dhe ecjes në rrugë me gjemba, po ashtu është e pamundur që një person nga njerëzit e rëndomtë t'i ngajë një dijetari të përsosur në fitimin e pasurisë.

DITA E PARË E TË DËRGUARIT TË ZOTIT ﷺ NË MEDINE



Ikja nga Kuba

I dërguari i Zotit pasi qëndroi 14 ditë në Kubë, në ditën e 15 i dërgoi haber fisit Nexhran. Më pas ata erdhën për ta shoqëruar gjatë rrugës drejt Medines. Pasi kishte hipur mbi devenë e Tij, Kasva,¹ vijnë djemtë e Amr Ibni Avf, i dalin përpara dhe i thonë: "O i dërguari i Zotit, a po ikën se je mërzi me neve apo po kërkon një vend më të bekuar?"

Rasulullahu (a.s) i cili gjitmonë vepronte me urdhër të Zotit tha: "Unë jam urdhëruar të udhëtoj drejt nje qyteti të bekuar. Prandaj mos ma pengoni devenë sepse ajo është urdhëruar se ku do të shkoj.²" Kjo shprehje ishte shumë e qartë. Edhe deveja e Tij kishte marrë urdhër dhe do ta zbatonte.

Fisi Nexhran e shoqëronte Atë nga të dyja anët ndërkohë që udhëtonin drejt Medines për tek shtëpia e Ejub el- Ensarit.

Pak pasi ishin nisur për rrugë, Ebu Bekri (r.a) shikon që një kalë vinte me shpejtësi drejt tyre. Menjëherë kthehet nga Rasulullahu (a.s) dhe i thotë se kalorsi

po vjen drejt tyre për ti sulmuar. Pasi i dërguari i Zotit e shikon kalorësin i lutet Allahut (xh.xh) ta hedhë atë përtokë. Pa ulur duart Akoma shikon që kali e kishte hedhur kalorësin përtokë. Pa kuptuar se çfarë i kishte ndodhur, kalorësi ngrihet, i kërkon falje dhe mundësi që të bëjë diçka për rata. Para pak minutash ai i cili tentoi ta vriste i lutesh atij ta falte dhe të bënte diçka për të! i dërguari i Zotit i jep atij detyrën të qëndroi deri në mbrëmje aty për të mos lejuar akënd që dëshironte ti bënte keq atyre. Kalorësi e mbajti fjalën dhe qëndroi deri në mbrëmje roje në atë vend.³

Në momentin që arritën në vendin e quajtur Harre, i dërguari Zotit lajmëroi Ensarët ku edhe ata e shoqëruan drejt Medines. Ndërkohë që në Medine, njerëzit, të gëzuar nga ardhja e Profetit, të gjithë shprehnin dëshirën e madhe për ta mbajtur mysafir në shtëpitë e tyre.

Ndërsa i dërguari i Zotit zgjodhi rrugën me të arsyeshme për të mos i ngelur hatri askujt duke u thënë se deveja e tij ka marrë urdhër të ndaloj atje ku duhet.

Sapo mbërrin në vendin e quajtur Belhubla shikon Abdullah ibni Ubej ibni Selulin dhe dëshiron ta vizitoi por

3. Ibn Sa'd, Tabakat, I/172

1. Ibn Sa'd, Tabakat, I/171

2. Semhudi, Vefau'l-Vafa, I/442

ai me një arrogancë të theksuar thotë: "Shko vizito ata të cilët të kanë ftuar."

Pas këtyre fjalëve kryetari i fisit Hazrexh Sad ibni Ubade thotë: "O i dërguari i Zotit mos u mërzit nga fjalët e tij, sepse populli i Medines i kishte dhënë fjalën se do ta bënë mbret por Allahu (xh.xh) atë të drejtë ta dha Ty dhe ky është i mërzhitur nga kjo."⁴

Ndërkohë që i dërguari i Zotit ja kishte lënë drejtimin e lirë deves së Tij, Kasvas dhe lutesh me fjalët e Nuhut (a.s): "Zoti im, më zbarko në një vend të bekuar, e Ti je më i miri i atyre që bëjnë vendosjen!"⁵

Vendi ku ndaloi Kasva

Ndërkohë, Kasva ndaloi në një tokë boshe të dy jetimëve Sehl dhe Suhejl nga fisi Nexhran. Ishte e qartë që kjo ishte një zgjedhje hyjnore. Kjo tokë e bekuar boshe gjatë kësaj kohe ishte përdorur nga ata pak myslimanë për të falur namazin pas Esad ibni Zurare. Madje edhe Musab ibni Umejri këtu e kishte falur namazin kur erdhi për ti mësuar Islamin Medinasve.⁶

Pas kësaj i dërguari i Zotit zbriti nga deveja dhe menjëherë filloi një garë për ta ftuar Atë në shtëpi. Vendi ku ndaloi deveja ishte shumë afër shtëpisë së Ebu Ejub el-Ensarit (Zoti qoftë i kënaqur prej tij). Pasi u hodh short doli pikërisht ky emër. Çështja ishte zgjidhur tashmë në një mënyrë të pranueshme për të gjithë.

Gëzimi historik në Medine

Medineja po jetonte ditët më të gëzueshme. Rrugët e saj nuk kishin përjetuar deri sot ditë kaq të lumtura. Njerëzit shprehnin gëzimin duke thënë "Erdhi Resulullahu! Erdhi Resulullahu! (paqja qoftë mbi Të)". I dërguari i Zotit ecte me një modesti të theksuar drejt shtëpisë ku do të qëndronte. Ndërkohë vajzat e fisit Nexhar kishin dal jashtë për të përshëndetur Rrasulullahun dhe nën shoqërimin e defit shprehnin dashurinë dhe mirënjohjen duke thënë: "Ne jemi vajzat e Nexharit! Sa mirë të jeshë komshi me Resulullahun!".

I dërguari i Zotit nuk e la pa e vlerësuar sjelljen e tyre. Menjëherë ndaloi, u kthye drejt atyre dhe i pyeti: "A më doni mua?" "Po, o i dërguari i Zotit" i thanë njëherazi. Pas kësaj përgjigjeje i dashuri i Zotit tha: "Pasha Allahun edhe une ju dua ju" dhe këtë e përsëriti 3 herë.⁷

Në shtëpinë e Ebu Ejub el-Ensarit

Pasi i dërguari i Zotit hyri në shtëpi, qëndroi ulur për tu qetësuar. Gjatë kësaj kohe ata që kishin dëshirë të merrnin mysafir në shtëpi Resulullahun gjetën mundësinë të vraponin drejt shtëpisë së Ebu Ejubit për të qerasur të dërguarin e Zotit. E para prej tyre ishte nëna e Zejd ibni Thabitit e cila shkoi bashkë me djalin e saj. Për këtë ditë ajo kishte përgatitur bukë me gjalp dhe qumësht. Ky ishte ushqimi i parë që i servirej Resulullahut (alejhi salam) në Medinë. Zejdi ja dha ushqimin duke i thënë se nëna e tij e kishte përgatitur

enkas për Ty. Ndërsa Resulullahu (alejhi salam) i bëri dua duke thënë: "Allahu e ktheftë në bereqet për ty dhe nënën tënde". Më pas thërriti edhe shokët dhe ushqimin e hëngrën bashkë. Ndërkohë pa mbyllur derën mirë Zejdi, vjen Sad ibni Ubade me një tas me ushqim. Kjo garë qerasjesh midis sahabësh zgjati përgjatë shtatë muajsh ku tre, katër sahabë në ditë dërgonin ushqim.⁸

Shtëpia e Ebu Ejubit (r.a) ishte dy katëshe. I dërguari i Zotit dëshironte të qëndronte në katin e parë, ndërsa Ebu Ejubi iu lut të kalonin në katin e dytë sepse nuk mund të jetonte i qetë duke ecur në majë të gishtave për të mos bërë zhurmë dhe të shqetësonte të dërguarin e Zotit. Ndërkohë që natën e parë u ngrit për të fal namaz tehexhudi por duke menduar se po qëndronte mbi kokën e Resulullahut (a.s) u ndal në një cep të dhomës dhe ashtu qëndroi deri në mëngjes. Të nesërmen i drejtohet Resulullahut (a.s) me insistim duke i thënë: "O i dërguari i Zotit, unë nuk mund të qëndroj në asnjë cep të katit të dytë duke menduar se poshtë këmbëve të mia je ti." Pas kësaj Ebu Ejubi zbriti në katin e parë.⁹

I dërguari i Zotit qëndroi plot shtatë muaj në këtë shtëpi deri sa u ndërtua dhoma e tij pranë mesxhidit Nebevi. Gjatë kësaj kohe Ebu Ejubi (r.a) tregon një kujtim që kishte jetuar me Resulullahun (a.s): "Një herë i ofrova ushqim në të cilin kishte qepë dhe hudhra. Pas pak i dërguari i Zotit na e ktheu ushqimin pa e prekur fare. Ky veprim na kishte bërë përshtypje dhe e pyetëm se mos vallë kishim gatuar ushqim jo të mirë. Ai (a.s) tha: "Unë në të mora aromë qepe dhe hudhre prandaj nuk e hëngra. Unë gjithmonë jam në kontakt me Zotin tim ndërsa ju mund ta hani atë ushqim." Pas kësaj përgjigjeje u rehatuam dhe e hëngrëm vetë atë ushqim. Ndërsa Resulullahut nuk i dërguam herë tjetër nga ai ushqim."¹⁰

Përfundim

Në betimin e Akabes u dha fjala nga Ensarët që do ta ruanin, strehonin dhe ushqenin të dërguarin e Zotit. Në këtë mënyrë fjala ishte mbajtur dhe Resulullahu (a.s) u mbrojt nga armiqt dhe ishte në një vend të sigurt. Tashmë pranë tij kishte një rrëz që e ruanin dhe kujdeseshin si për vetet dhe familjet e tyre. Ditën e vështirë të Mekes kishin ngelur pas. Në jetën e Tij dhe në historinë Islame po fillonte një epokë e re. Drita e Islamin që donin ta mbysnin në Meke tashmë kishte kaluar në qytetin e ndritur të Medines. Me ardhjen e kësaj drite dhe me ardhjen e përfaqësuesit të fundit të saj, këtij qyteti i ishte ndryshuar emri dhe misioni. Tashmë ai quhej "Medinetu Rrasul - Qyteti i Resulullahut" ose "Medinei Munevvere - Qyteti i Ndritur". Për këtë arsye ky qytet me kalimin e kohës, sipas fjalëve të ndritura të dërguarit të Zotit mori dhe epitete të tjera si "vendi i besimit, vendi i hixhretit dhe kubeja e Islamit."

4. Semhudi, I/445

5. Surja Muminun 23\29

6. İbn Sa'd, Tabakat, I/174

7. Semhudi, Vefau'l-Vefa, I/451

8. İbn Sa'd, Tabakat, I/173

9. Semhudi, Vefau'l-Vefa, I/454

10. İbn Hishami, I/110

Pendimi Shenjë e imanit



قُلْ يٰٓعِبَادِيَ الَّذِيْنَ اَسْرَفُوْا عَلٰٓى اَنْفُسِهِمْ لَا تَقْنَطُوْا مِنْ رَّحْمَةِ اللّٰهِ ۚ اِنَّ اللّٰهَ يَغْفِرُ
الدُّنُوْبَ جَمِيْعًا ۚ اِنَّهٗ هُوَ الْغَفُوْرُ الرَّحِيْمُ

"Thuaj: "O robërit e Mi që keni tejkaluar caqet kundër vetvetes (duke bërë gjynahe)! Mos i humbisni shpresat nga Mëshira e Allahut, po Allahu i falë të gjitha gjynahet. Vërtet që Ai është Falës i Madh, Mëshirëplotë."

(Kurani, Zumer, 53)

Hyrje

Allahu i Madhërishëm e ka krijuar njeriun me një natyrë të ndryshme nga krijesat e tjera, me mundësi për t'u orientuar edhe kah e mira edhe kah e keqja. Prandaj, njeriu, nëse orientohet drejt së mirës, ai mund të arrij gradën e melaqeve, sikundër që, nëse shkon kah e keqja, mund të bjerë në një shkallë më të ulët se kafshët.

Ndonëse Allahu ka kërkuar nga njeriu që ai t'i përmbahet rrugës së Tij, t'i respektoj urdhëresat dhe ndalesat e Tij, ai, megjithatë nganjëherë, me vetëdije ose pa të, me qëllim ose pa të, mund edhe të futet në vorbullën e mëkateve, të bëjë gabime prej më të ndryshmeve, të bëjë gjynahe.

Gjynahu, si fenomen, daton që nga njeriu i parë Ademi a.s., i cili i nxitur nga shejtani i mallkuar, e shtyri që ta hajë pemën e ndaluar (pemën e përjetësisë - shexheretul huld). Me këtë veprim, Ademi nuk e respektoi udhëzimin e Allahut dhe bëri veprim të gabuar përse meritoi dënimin. Kështu që, bërja e gabimeve ka vazhduar që nga hazreti Ademi e do të vazhdojë derisa të ketë jetë në këtë Tokë. Në të vërtetë, ata, Ademi a.s. dhe Hava, qenë të ndërgjegjshëm për gabimin e bërë, prandaj me përlulsi i kërkuar ndjesë Allahut:

قَالَا رَبَّنَا ظَلَمْنَا أَنْفُسَنَا وَإِنْ لَمْ تَغْفِرْ لَنَا وَتَرْحَمْنَا لَنَكُونَنَّ مِنَ الْخَاسِرِينَ.

"Ata (të dy) thanë: "Zoti ynë! Ne gabuam dhe dëmtuam vetveten, e nëse Ti nuk na falë dhe nuk na mëshiron, sigurisht se do jemi nga të humburit."

Natyrisht, Allahu i Gjithëmëshirshëm, i Cili është pranues i pendimit dhe Falës i Madh, Ademit dhe Havasë ua pranoi pendimin - teuben dhe i fali. Duke qenë se, mëshira e të Madhit Zot gjithmonë ka qenë mbi çdo gjë, dhe, pikërisht, falë kësaj mëshire të pakufizuar, njerëzimit iu ka dhuruar edhe mundësia e pendimit dhe e kërkim-faljes, e që me të drejtë mund të konsiderohet ndër dhuntitë më të mëdha të Allahut ndaj robërve të Tij.

Ç'është në të vërtetë pendimi ?

Në gjuhën arabe, nocioni "pendesë" kuptohet nga shprehja "et-teubetu" dhe derivatet që dalin nga kjo. Ç'është në të vërtetë pendimi ?

Pendesa ose pendimi është që njeriu ta ndjenë në shpirtin e tij ndjenjën e pishmanllëkut, të pendohet për veprën e ligë që ka bërë dhe të vendos me sineritet që të njëjtën ose të ngjashme më mos me bërë. E njëjtë me këtë është edhe kërkim falja (istigfari), madje aq sa në përdorimin e zakonshëm njëra është bërë sinonim i tjetrës. Lidhur me pendesën - teuben, për ta kuptuar akoma më saktë, nuk mund e të mos e përmendim me këtë rast hadithin e Pejgamberit a.s., i cili me një rast kishte thënë:

عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَعْقِلٍ قَالَ: كَانَ أَبِي عَبْدَ اللَّهِ ابْنَ مَسْعُودٍ فَمِيعَهُ يَقُولُ: سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ يَقُولُ: "الْإِنْدَمُ تَوْبَةٌ".

Abdullah ibni Ma'kili tregon: babai im ka qenë bashkë me Abdullah ibni Mesudin dhe e kishte dëgjuar duke thënë: e kamë dëgjuar Pejgamberin a.s. kur thoshte: "Të pendohesh (të ndjehesh pishman) nga mëkati quhet teube."

Ndërkaq, me një rast tjetër, Pejgamberi a.s. kishte thënë:

عَنْ عَبْدِ اللَّهِ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: "التَّوْبَةُ مِنَ الذَّنْبِ أَنْ يَتُوبَ مِنْهُ ثُمَّ لَا يَعُودَ فِيهِ".

Transmeton Abdullah ibni Mesudi se Pejgamberi a.s. kishte thënë: "Të pendohesh nga mëkati, do të thotë ta braktisë mëkatin dhe mos të kthehesh kurrë më në të."

Nga thëniet pejgamberike kuptohet se pendesa është e kushtëzuar me sineritet, jo thjesht një formalitet, sepse në të kundërtën, ajo nuk do të kishte ndonjë vlerë.

Praktika e Pejgamberit a.s. në raport me pendimin

Nuk ka dyshim se Pejgamberi a.s. është shëmbëlltyra më e përsosur në çdo aspekt të jetës e gjithashtu edhe kur bëhet fjalë për pendesën. Në këtë kuptim, vërejmë se ka shumë hadithe të Pejgamberit përkitazi me kërkim faljen dhe pendimin.

Pejgamberi a.s., ndonëse ka qenë njeriu që më së shumti është ruajtur nga mëkatet, ndonëse atij ia ka falur Allahu xh.sh. të gjitha mëkatet eventuale, të kaluarat dhe të së ardhmes, megjithatë ai shpesh herë iu ka drejtuar Allahut me lutje për ta falur. Ja se si e përshkruan El-Egarr el-Muzeniu rastin e Pejgamberit:

عن الأغر بن يسار المزني رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: "يَا أَيُّهَا النَّاسُ، تَوْبُوا إِلَى اللَّهِ وَاسْتَغْفِرُوهُ، فَإِنِّي أَتُوبُ فِي الْيَوْمِ مِائَةَ مَرَّةٍ"

Transmeton El-Egarr bin Jesar el-Muzeni r.a., se ka thënë: ka thënë Pejgamberi a.s.: "O njerëz! Pendohuni tek Allahu dhe kërkon falje nga Ai, sepse unë pendohem nga njëqind herë në ditë."

Jo vetëm kaq, por Resulullahu me një rast, siç transmeton Eneş bin Malik, kishte konstatuar:

عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: كُلُّ بَنِي آدَمَ خَطَاءٌ وَخَيْرُ الْخَطَايِنِ التَّوَابُونَ

Enes bin Maliku tregon se Pejgamberi a.s. kishte thënë: "Të gjithë bijtë e Ademit janë gabimtarë, por më i miri nga gabimtarët është ai i cili pendohet."

Nuk ka dyshim se mëshira e të Madhit Zot ndaj robërve të Tij është shumë e gjerë, dyert e saj për ta janë vazhdimisht të hapura, Ai e zgjat dorën e Tij ditën që të pendohet keqbërësi i natës, dhe e zgjat dorën e Tij natën që të pendohet keqbërësi ditës. Transmeton Ebu Musa el-Esh'arij r.a. se Pejgamberi a.s. kishte thënë:

وَعَنْ أَبِي مُوسَى عَبْدِ اللَّهِ بْنِ قَيْسٍ الْأَشْعَرِيِّ، رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ، عَنِ النَّبِيِّ ﷺ قَالَ: إِنْ اللَّهُ تَعَالَى يَبْسُطُ يَدَهُ بِاللَّيْلِ لِيَتُوبَ مُسِيءُ النَّهَارِ، وَيَبْسُطُ يَدَهُ بِالنَّهَارِ لِيَتُوبَ مُسِيءُ اللَّيْلِ حَتَّى تَطْلُعَ الشَّمْسُ مِنْ مَغْرِبِهَا.


"Allahu e zgjat dorën e Tij ditën që të pendohet keqbërësi i natës, dhe e zgjat dorën e Tij natën që të pendohet keqbërësi ditës. Kjo zgjat deri sa të lind dielli nga Perëndimi."

Për më tepër, Pejgamberi a.s. me një rast kishte konstatuar se besimtari që pendohet sinerisht për mëkatet e tij, është sikurse ai që nuk ka fare mëkate, sepse mëshira e Allahut xh.sh. është aq e madhe sa që këtë ia mundëson besimtarit. Pejgamberi a.s. kishte deklaruar:

عَنْ أَبِي عُبَيْدَةَ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ عَنْ أَبِيهِ قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: "الْثَّانِبُ مِنَ الذَّنْبِ كَمَنْ لَا ذَنْبَ لَهُ"، ابْنُ مَاجَةَ.

Transmeton Ebu Ubejde bin Abdil-lahu se babai i tij (Abdullah ibni Mesudi) kishte dëgjuar Pejgamberin të ketë thënë: "Ai që pendohet nga mëkati është si ai që nuk ka bërë mëkat."

NAMAZI DHE APOPTOZA



Ne lindim me trupa fizikë, jetojmë në këta trupa dhe përfundimisht, i japim lamtumirën kësaj bote, duke i lënë trupat tanë pas. Trupat tanë na janë besuar dhe ne duhet të dimë se si t'i mbrojmë këto amanete, si dhe pasojat, si në këtë botë ashtu edhe në tjetrën, të shkeljes së këtij besimi. Një aspekt i rëndësishëm i kësaj detyre është të kujdesemi për mirëqenien tonë fizike dhe shpirtërore.

Anatomia fizike e një personi ndërvepron me anatominë e tij/saj shpirtërore. Çdo defekt, sëmundje ose shqetësim në njërin prej tyre do të ndikojë tek tjetra. Në një nga thëniet e tij të famshme, Profeti Muhamed, paqja qoftë mbi të, vë në dukje këtë ndërveprim me theksin në zemrën si qendrën e përbërjes sonë fizike dhe shpirtërore: *"Kujdes, në trup ka një copë mishi; nëse është i shëndoshë, i gjithë*

trupi është i shëndoshë dhe nëse është i prishur, i gjithë trupi është i prishur. Ajo është zemra."

Fjala "zemër" ka dy kuptime. Njëra tregon pjesën më vitale të trupit, e cila ndodhet në pjesën e majtë të gjoksit dhe i ngjan një boçe pishe. Për sa i përket strukturës dhe indeve të saj, zemra është e ndryshme nga të gjitha pjesët e tjera të trupit. Ajo ka dy veshore dhe dy barkushe, është origjina e të gjitha arterieve dhe venave, lëviz vetë, funksionon si një motor dhe, si një pompë thithëse, lëviz gjakun nëpër sistemin e qarkullimit.

Në terminologjinë sufiste, "zemra" nënkupton aspektin shpirtëror të zemrës biologjike si qendra e të gjitha emocioneve dhe aftësive (intelektuale dhe shpirtërore), të tilla si perceptimi, vetëdija, ndjesia,

1. Buhariu, Iman, 39; Muslimi, Musakat, 107

arsyetimi dhe vullneti. Sufitë e quajnë atë "të vërtetën njerëzore", filozofët e quajnë atë "vetja e të folurit". Natyra reale e një individi gjendet në zemër. Në lidhje me këtë aspekt intelektual dhe shpirtëror të ekzistencës, njeriu është në gjendje të njohë, perceptojë dhe kuptojë. Shpirti është thelbi dhe dimension i brendshëm i kësaj aftësie, shpirti biologjik ose shpirti i tij.

Këto dy dimensione janë të ngjashme me njëra-tjetrën. Mund të themi se në të dyja ka një sistem imunitar. Përvojat që fitojmë dhe mënyra se si i trajtojmë qeniet tona fizike dhe shpirtërore rezultojnë në shëndet ose sëmundje.

APOPTOZA

Ne jemi të pajisur me një mekanizëm të balancuar madhështor për të mbrojtur trupin tonë fizik. Sistemi ynë imunitar punon me ushtrinë e tij të madhe për të parandaluar sëmundjet, qelizat e dëmtuara hiqen menjëherë dhe defektet trajtohen përmes mekanizmave elegantë të kontrollit.

Apoptoza është një nga këta mekanizma dhe është i jashtëzakonshëm. Apoptoza është shkatërrimi i programuar i qelizave që janë ose mund të përbëjnë një kërcënim për trupin. Për shembull, qelizat që janë të infektuara me viruse dhe çdo ADN të dëmtuar eliminohen përmes apoptozës. Mutacionet e mundshme në ADN-në qelizore mund të rezultojnë në zhvillimin e kancerit dhe për këtë arsye, shkatërrimi i qelizave të tilla të dëmtuara është vendimtar.

Apoptoza luan një rol të madh në një sërë ngjarjesh patologjike dhe fiziologjike. Formimi dhe liza e qelizave janë më të rëndësishmet nga këto ngjarje fiziologjike. Në indet ku formimi dhe liza e qelizave janë me ritme të shpejta të tilla si lëkura, epiteli i zorrëve, gjaku dhe mëlcia, qelizat e plakjes shkatërrohen përmes apoptozës për të krijuar vend për qeliza të reja. Çrregullimet në ekuilibrin apoptotik u treguan të jenë efektive në disa sëmundje kardiake, sëmundje autoimmune si diabeti dhe çrregullime neurodegenerative si sëmundja e Alzheimerit.

Falë këtij mekanizmi, njerëzit mund të bëjnë jetë të shëndetshme dhe të ekuilibruar. Çdo dëmtim në këtë ekuilibër mund të rezultojë në sëmundje dhe kancere për shkak të përhapjes së ADN-së së dëmtuar. Ndërsa ngarkesa e qelizave që nuk funksionojnë dhe shkalla e dëmtimit të qelizave tona rritet, shëndeti i trupave tanë fizikë do të bjerë.

Mirëqenia e anatomisë sonë shpirtërore është e ngjashme me mirëqenien e trupit tonë fizik. Dimension i shpirtëror humbet ekuilibrin e tij dhe përkeqësohet për shkak të mëkateve dhe plogështisë.

Prirja jonë e papërlyer është krijuar në mënyrë që ne të mund të njohim, të njohemi nga afër dhe ta duam Zotin tonë. Që sistemi ynë imunitar shpirtëror të funksionojë siç duhet, ne duhet të bëjmë një jetë

që është në përputhje me këtë prirje. Për sa kohë që kujdesemi për shpirtin dhe zemrën tonë, sistemi ynë imunitar shpirtëror do të jetë i fortë dhe i pajisur mirë kundër çdo sulmi nga jashtë. Megjithatë, nëse lejojmë që zemra jonë të goditet nga shigjetat e mëkatit, nuk i qëndrojmë larg mjedisit të rrezikshëm ose nuk marrim masat e duhura kundër sëmundjeve, kjo do të hapë rrugën për një deformim të zemrës dhe jetës sonë shpirtërore. Një person që vuan nga një deformim i tillë mund të riformohet ose të rikthehet në disponimin e tij/saj origjinal vetëm duke kërkuar faljen e Zotit. Çdo mëkat e dëbon mëkatarin nga Zoti, duke e afruar më shumë me mosbesimin. Vetëm kërkitimi i faljes nga Zoti mund ta ndihmojë një person të heqë qafe mëkatet dhe të largojë njollat e lëna pas nga ato mëkate.²

Nëse ne mund ta trajtojmë siç duhet këtë mekanizëm të kërimit të faljes nga Zoti, Zoti ynë do të na pastrojë me hirin e Tij të pafund, duke siguruar që ne të mund ta mbajmë jetën tonë shpirtërore në një mënyrë të shëndoshë. "Lutja dhe besimi ndaj Zotit forcojnë shumë prirjen tonë për të bërë mirë, dhe pendimi dhe kërkitimi i faljes e mposhtin prirjen tonë për të keqen dhe thyejnë shkeljet e saj," shkroi Bediuzzaman Said Nursi. Kërkitimi i faljes së Zotit është një mundësi për ne për të pastruar shpirtin tonë, një mjet për shërim dhe një mburojë për mbrojtje, ashtu siç është apoptoza për trupin tonë. Edhe Nursi vëren se aftësitë për kryerjen e veprave të këqija mund të zëvendësohen me ato për kryerjen e veprave të mira përmes procesit të kërimit të faljes nga Zoti.

Këtu duhet theksuar se edhe nëse çdo qenie njerëzore është e pajisur me aftësinë për të njohur Zotin në prirjen dhe ndërgjegjen e tij origjinale, ai/a jo është gjithashtu i pajisur me prirje që mund të përdoren për të mirë ose për të keq në mënyrë që ai/a jo arrin përsosmërinë përmes sprovave dhe mundimeve. Në këtë kontekst, urdhrat dhe ndalesat hyjnore shërbejnë për t'i pajisur qeniet njerëzore me një "disponim të dytë". Prandaj, një person mund t'i devijojë ato prirje në prirjen e tij/saj drejt së mirës duke iu bindur urdhrave të Zotit.

Mekanizmat për të kërkuar falje dhe apoptozë nga Zoti janë favore hyjnore që na janë dhënë me dashamirësi, në mënyrë që të sigurohet shëndeti ynë shpirtëror dhe fizik. Sa më shumë t'i kërkojmë falje Atij, aq më të shëndetshëm do t'i gjejmë shpirtin tanë dhe ndoshta edhe trupin tanë. Ne duhet të shpresojmë se mund të përparojmë si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër si mjekët, të cilët, duke përfutur nga shkencat moderne dhe fetare, mund t'i çojnë pacientët tanë drejt shërimit të vërtetë.

Përktheu: Erion Sukaj

2. Tirmidhiu, Tefsir el-Surah (83), 1.

Ah sikur ta dinin...



E pyetën njëherë Nastradinin: "Sa e madhe është bota?" Ndërkohë pranë tyre kalonte një kortezh varrimi. Duke treguar për nga i vdekuri Nastradini u përgjigj: "Pyeteni më mirë atë. Ai sapo e mati."

Sa kut është bota? Është kaq e vogël saqë me gjithë përpjekjet s'na e nxë as trishtimin, as lumturinë; as brengën, as ngadhënjimin. Nuk na e nxë as rendjen tonë në ekzistencë e cila zbehet, shuhet deri në fikje. Të gjitha ngelen sërish brenda nesh si një makth apo si një dritë. Jashtë botës që ndërtojmë përbrenda, në botën e dukshme nuk ka asgjë që mbetet.

Koha në të bëhet e pakapshme. Rrëshqet duke na lënë të habitur me duart e zgjatura për të ndalur ikjen. Zbrazëtia na i tkurr ëndrrat që vdesin përditë. Jetët tona, një skenar i trishtuar, lavdi të heshtura në kufijtë e botës që priren të mblidhen derisa nuk e sheh më dhe vdekja të vjen. Atëherë sytë zgjerohen dhe e thithin në gropa të tmerruara; rini e bukuri e tretur në plakje e shëmti, pasuri e humbur në mangësi të përhershme, gjallëri e brejtur nga sëmundja e brenga, fundi-lot i hidhur për atë që ishte dhe nuk ishte nën kapak të rëndë.

Kjo botë nuk është amshim. Botën e madhe të njeriut nuk mund ta nxërë. Ato takohen tangent me njëra-tjetrën për t'u njohur me vetveten dhe rrëshqasin tutje duke mos u ndeshur kurrë më. Atëherë sytë zgjerohen dhe thithin në gropa të tmerruara këtë njohje për t'u lexuar njëherë në sprovën brenda varrit dhe për t'u rilexuar në sprovën e rëndë të Ditës së Gjykimit.

Nga Sehl b. Sadi r.a. transmetohet se i dërguari i Allahut a.s. ka thënë: "Sikur kjo botë tek Allahu të vlente sa një krah i mushkonjës, prej saj jobesimtarit nuk do t'i lejonte të shijonte as edhe një pikë ujë."

Uji i kësaj bote nuk e shuan etjen. Ai e shton atë dhe mallin për freskinë. A e shuan uji i saj etjen e varrit? Sa kut është ajo për të shuar flakët e përtëritshme të xhehenemit? Është kufi i ngushtë ku vërtitesh dhe të mbyt angështia për të dalë, për t'ia dalë me shpirtin. Gjithçka që na shkruhet është bota që ndërtojmë përbrenda; makth apo dritë. Makthi na mbledh në frikë dhe dhembje, ndërsa drita na i hap kufijtë drejt përjetësisë.

Le t'i pyesim të vdekurit tanë për të

vërtetat e tyre. Ata flasin me atë që ka vdekur brenda nesh, me kohën që iku bashkë me ta. Ata flasin me vdekjen tonë të përditshme që na zhurmon si një zile alarmi dhe na thërret në jetë. Jeta është me të Përrjetshmin. Shpresa buron nga Shpresëdhënësi. Kjo dynja është e errët dhe e zjarrmuar si një farkë për të mençurin, i cili punon në të çelësin që ia hap dyert për t'u kthyer tek Allahu në siguri. Dyert e xhehenemit janë vetë të hapura. Ai thërret:

"A ka më?" Thërret të pakujdesshmit. Ata që i zgjeruan kufijtë e dynjasë me sytë e mendjet e tyre dhe shkanë jashtë, në gropat e zjarrit.

Le t'i pyesim të vdekurit tanë se çfarë kanë lënë pas dhe çfarë gjetën! Ata flasin me hijet e emrave të tyre të harruara, me gëzimin e lotët e tharë regjistruar në kujtesë të padukshme.

Ata flasin me kumbimin e frikës së përhershme që na e përcjell i njëjti fat. Të gjithë jemi të përcaktuar me vdekje, me harrim prej kësaj bote dhe siguria e përhershmërisë na është premtuar vetëm në ahiret. "Jeta e kësaj bote nuk është tjetër pos dëfrim e lojë, ndërsa vetëm ajo botë është jetë, sikur vetëm ta dinin." (Ankebut : 64)

Sytë tanë tashmë janë të hapur për këtë botë e të mbyllur për jetën tjetër. Ajo mundet të na joshë e të na kërcënojë, sepse e prekim me dorë lëvozhgën e saj. Duhet kurajë ta shtrëngojmë e ta thyejmë për të zbuluar boshësinë. Prandaj e përcjellim vdekjen, prandaj e kujtojmë, prandaj e ndiejmë, ... dhe mundemi ta matim botën. Tani që është ende herët. Tani që provimi s'ka mbaruar dhe përgjigja ka kohë. Duke përcjellë të vdekurit dhe dëgjuar fjalët e tyre të pazëshme. Duke fërkuar sytë dhe ardhur në vete. Sikur të vinim në vete sa më parë! Vdekja diku afër na pret, se bota është shumë e vogël për të qenë ajo larg. Shpejt vjen dita kur gjithçka merr vlerën e vet të vërtetë. Duke udhëtuar për në atë jetë, sigurisht do ta mësojmë madhësinë dhe vlerën e dynjasë. Dhe do të përgjigjemi për masën që dikur patëm zgjedhur.

"Jeta e kësaj bote nuk është tjetër pos dëfrim e lojë, ndërsa vetëm ajo botë është jetë, sikur vetëm ta dinin" (Ankebut, 64).

Me male e me gurë, o Zot...

Me male e me gurë o Zot
lem t'thirri ty.
Me zogj sabahi o Zot
lem t'thirri Ty.

Me peshqi n'ujë, o Zot
e me gazele në shkreti'
si një abdall 1, ja Hu
lem t'thirri Ty.

Me Isën n'qiell, o Zot
e me Musën n'Tur
me shkop n'dorë, o Zot,
lem t'thirri Ty.

Edhe me Ejubin derte plot
e me Jakubin sy përlot'
me Muhamedin e dashtun fort
O Zot, lem t'thirri Ty.





NJOFTIM I RËNDËSISHËM

ME PËRFUNDIMIN E AFATIT TË REGJISTRIMEVE PËR NXËNËSIT AKTUALË DHE PËR ATA QË KANË FITUAR TË DREJTËN E REGJISTRIMIT PËRMES PROCESIT TË PRANIMEVE, JU INFORMOJMË SE:

DUKE FILLUAR NGA DATA 16 QERSHOR 2025, REGJISTRIMET DO TË JENË TË HAPURA EDHE PËR NXËNËS NGA SHKOLLA TË TJERA, VETËM NË KLASAT KU KA ENDE KUOTA TË LIRA.

PRANOHEN DJEM DHE VAJZA NGA KLASA E 10-TË DERI NË KLASËN E 12-TË.

PËR MË SHUME INFORMACION MBI KLASAT ME VENDE TË LIRA DHE PROCEDURAT E REGJISTRIMIT, JU LUTEMI KONTAKTONI SEKRETARINË E SHKOLLËS OSE VIZITONI FAQEN TONË ZYRTARE:

+355 69 4787 645
WWW.SEMA.EDU.AL